



Hulumtim me pjesëmarrje aktive

Temat e hulumtimit:

Braktisja e shkollës

Martestat e hershme

Diskriminimi nga mësimdhënësit

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor

Ky raport erdhi si rezultat i hulumtimit të kryer në kuadër të projektit “Liderët e rinj romë në veprim”, projekt i cili implementohet nga Save the Children në Kosovë në partneritet me organizatën Iniciativa 6.

Save the Children është organizatë udhëheqëse e pavarur për fëmijë me programet e saja në 120 shtete. Misioni ynë është që të frymëzojë ndryshime inovative në mënyrën se si bota i trajton fëmijët, dhe për të arritur ndryshime të menjëhershme dhe të qëndrueshme në jetën e tyre.

Iniciativa 6 është organizatë lokale jo qeveritare e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RAE). Objektivat e Iniciativa 6 janë: integrimi i komuniteteve RAE, sidomos integrimin e fëmijëve dhe të rinjve në sistemin e arsimit, përmirësimi i të drejtave të njeriut, ndërtimin e një shoqërie demokratike, duke krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të mira me organizata të tjera të ngjashme.

Pikëpamjet e autorit të këtij botimi nuk paraqesin domosdoshmërisht politikën dhe mendimet e Save the Children dhe Iniciativa 6.

HULUMTIM ME PJESËMARRJE AKTIVE

Hulumtimi është bërë nga:

Një grup i të rinjëve të cilët janë pjesë e projektit **“Liderët e Rinj Romë në Veprim”**

Raporti është përgaditur nga:

Erëblina Elezaj

Lektorimi

AB & Associates – *Translation Services Agency*

FALËNDERIMET

Falënderojmë për zemërsisht liderët dhe vullnetarët e rinj të komunës së Prizrenit dhe Gjakovës për dëshirën dhe vullnetin e tyre që të kontribuojnë në këtë hulumtim: Adelina Kabashi; Alban Morina; Albertina Monika; Amir Osmani; Avnore Morina; Besart Mersula; Bleta Qehaja; Bujar Luboja; Dardan Fetahaj; Egzon Sehari; Erxhan Sehari; Fatlum Kryeziu; Furkan Ago; Gezim Qehaja; Granit Hoxha; Ilajda Qorri; Jemina Osmani; Lavdim Morina; Majlinda Shala; Masar Derri; Mirjeta Qehaja; Nita Efendia; Nuhi Morina; Resul Milaimi; Rreze Oseku; Sanije Mergjollar; Valon Gashi; Vilson Dura; Ylveha Braha dhe Zejnepe Qabrati.

Falënderojmë edhe Znj. Erëblina Elezaj, konsulenten e këtij hulumtimi, për komentet e saj, udhëzimet, analizën e të dhënave, hartimin e pyetësorëve, këshillat dhe hartimin e raportit.

Gjithashtu i falënderojmë organizatat HandiKOS dhe One to One Kosova/PEMA si dhe drejtorët e shkollave fillore në Gjakovë: "Zekerija Rexha"; "Mustafa Bakija"; "Mazllum Këpuska"; "Fehmi Agani"; "Selman Riza" dhe "Zef Lush Marku" për bashkëpunimin e ngushtë dhe kontributin e tyre gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

Përshkrim i shkurtër i projektit.....	8
Përmbledhje e raportit	8
Raporti është i strukturuar si vijon:.....	9
Qëllimi i projektit.....	9
Metodologjia	10
PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË GRUPEVE HULUMTUESE	12
Braktisja e shkollës.....	12
Martesat e hershme.....	12
Diskriminimi nga mësimdhënësit.....	13
Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor	14

KAPITULLI II

BRAKTISJA E SHKOLLËS.....	16
Problemi	16
Metodologjia	17
Gjetjet kryesore	17
Arritjet 18	
Kufizimet dhe sfidat e hulumtimit	19
Rekomandimet	19
MARTESAT E HERSHME	20
Problemi	20
Gjetjet kryesore	21
Arritjet	25
Kufizimet dhe sfidat e hulumtimit	26
Rekomandimet.....	26
DISKRIMINIMI NGA MËSIMDHËNËSIT.....	28
Problemi	28
Metodologjia	29
Gjetjet kryesore	29
Arritjet	32
Kufizimet dhe sfidat e hulumtimit.....	32
Rekomandimet.....	33
PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SISTEMIN SHKOLLOR.....	35
Problemi.....	35
Metodologjia	36
Gjetjet kryesore	37
Arritjet	40
Kufizimet dhe sfidat e hulumtimit	40
Rekomandimet.....	41

KAPITULLI III

ARRITJET, MËSIMET DHE NDIKIMI I HULUMTIMIT NË LIDERËT E RINJ DHE KOMUNITETIN.....	44
Liderët	44
Organizata	45
Komuniteti.....	45
Vështirësitë dhe sfidat	46
Rekomandimet.....	47
REFERENCAT	50
SHTOJCA	51

TABELAT

Tabela 1: Numri i të rinjve të martuar para moshës 18 vjeç, sipas gjinisë	22
Tabela 2: Numri i të rinjve të cilët kanë pohuar se partneri/ja e tyre ka qenë nën 18-vjeç/e kur janë martuar, sipas gjinisë.....	22

FIGURA

Figura 1: Vendimmarrja për martesë, sipas llojit të martesës.....	23
Figura 2: Arsyet kryesore për martesë të hershme, sipas të rinjve të anketuar	24
Figura 3: Arsyet për martesë të hershme, sipas prindërve të anketuar	25
Figura 4: Arsyet për mosvijim të orëve shtesë (gjuhë shqipe, gjuhë angleze, matematikë, etj) të organizuara në shkollë	31
Figura 5: Arsyet për mospjesëmarrje në aktivitetet e shkollës (gara, kuize, kori i shkollës, aktivitetet kulturore, aktivitetet sportive, etj.)	31
Figura 6: Lloji i aftësisë së kufizuar të fëmijëve	38
Figura 7: Arsyet për mosvijimin e mësimi.....	39

LISTA E SHKURTESAVE

ECMI	European Centre for Minority Issues (Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve)
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
LYRA	Leaders – Young Roma in Action (Liderët – Të Rinjtë Romë në Aksion)
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
QPS	Qendra për Punë Sociale
UNFPA	United Nations Population Fund (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi)
UNICEF	United Nations Children’s Fund (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët)

KAPITULLI



PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT

Tranzicioni i të rinjve Romë¹ nga mosha e rinisë në moshën e pjekurisë pengohet nga mungesa e mundësive brenda dhe jashtë komuniteteve të tyre si dhe nga vështirësitë për qasje në të drejtat njerëzore për shkak të diskriminimit të vazhdueshëm dhe marginalizimit. Paragjykimet dhe stereotipet ndaj këtyre komuniteteve janë shumë të përhapura dhe shpesh mbesin të padiskutuara në politikë dhe shoqëri.

Gjithashtu, mungesa e vëmendjes nga politikat kombëtare dhe ndërkombëtare për problemet specifike të të rinjve Romë e bën shumë të vështirë angazhimin e tyre në aktivitete shoqërore si dhe ua pamundëson të bëhen liderë të ndryshimeve shoqërore.

Mënyra e vetme për ta shkëputur/ndërprerë këtë rreth vicioz dhe për t'i përfshirë këta të rinj në shoqëri është përmes përfshirjes sociale si dhe angazhimit të vazhdueshëm në procese shoqërore. Ndërtimi dhe avancimi i kapaciteteve të të rinjve Romë si dhe ofrimi i mundësive për të marrë pjesë në jetën sociale dhe të bashkësisë tashmë janë esenciale.

Projekti *Leaders Young Roma in Action (LYRA)*, është projekt rajonal i financuar nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe zbatohet në tri shtete: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Projekti angazhon 60 liderë të rinj Romë dhe jo-Romë dhe ka për synim 10 komunitete të Ballkanit Perëndimor, gjegjësisht: në Shqipëri (*Korça, Fieri dhe Pogradeci*), Bosnje dhe Hercegovinë (*Sarajevë, Banja Llukë, Tuzla, Bijelinja dhe Mostar*) dhe Kosovë (*Prizren dhe Gjakovë*).

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Qëllimi i projektit LYRA (Leaders – Young Roma in Action) është fuqizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve dhe kompetencave të liderëve të rinj (18-26 vjeç) Romë dhe jo-Romë dhe aktivistëve në Ballkanin Perëndimor për të ndërmarrë hapa efektiv në nivel lokal, nacional dhe rajonal për të përmirësuar përfshirjen sociale, mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e Romëve.

Përmes projektit rajonal, 60 liderë të rinj Romë dhe jo-Romë do të fuqizohen për të identifikuar problemet e përbashkëta të përjashtimit social dhe diskriminimit me të cilat ballafaqohen Romët dhe për të hartuar aktivitete të zbatueshme të avokimit për t'i adresuar këto probleme përmes shkëmbimit dhe krijimit të rrjetave të bashkëpunimit ndër-kufitar, angazhimit të shoqërisë civile dhe avokimit me institucione shtetërore dhe mekanizma ndërkombëtare të cilat merren me trajtimin e çështjeve të Romëve.

Komponenta e identifikimit dhe hulumtimit të problemeve të diskriminimit dhe përjashtimit social në komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë ka përfshirë 28 të rinj të cilët në bazë të trajnimeve dhe diskutimit të njohurive të tyre kanë vendosur të hulumtojnë katër (4) probleme kyçe në bashkësitë e tyre. Në komunën e Prizrenit, liderët e rinj kanë konsideruar se problemet kryesore në komunitetin e tyre janë *Braktisja e shkollës dhe Martesat e hershme*, ndërsa në atë të Gjakovës *Diskriminimi nga mësimdhënësit dhe Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor*. Secila prej këtyre katër temave është hulumtuar dhe analizuar përmes anketave me fëmijë, prindër dhe shkolla të cilat janë zhvilluar për një periudhën kohore prej 2-javësh nga një grup punues i përbërë prej 5 liderëve të rinj dhe 2 vullnetarëve.

¹ Në këtë projekt, termi "Romë" përdoret për përshkrimin, pa diskriminim, e të gjitha grupeve rome – Romëve, Ashkalive, Egjiptasve dhe të tjerëve të cilët janë të pranishëm në vendet ku është duke implementuar projekti

Raporti Nacional i Projektit të Hulumtimit të LYRA-s (Leaders – Young Roma in Action) është sintezë e katër raporteve lokale, të përgatitura nga secili grup punues, i cili përfshin një përshkrim të shkurtër të problemit, hulumtimin në terren, gjetjet e hulumtimit si dhe rekomandimet për aktivitetet që duhen ndërmarrë për të trajtuar problemin në nivel të bashkësisë, në nivel lokal dhe në nivel nacional. Pasi që njëri ndër qëllimet kryesore të projektit është fuqizimi i të rinjve për të identifikuar problemet në komunitetet e tyre dhe për të intervenuar menjëherë, rëndësi e veçantë në raport i është kushtuar procesit të punës së liderëve të rinj, duke përfshirë këtu arritjet e tyre, ndikimin e hulumtimit dhe aktiviteve të projektit në komunitete dhe organizatë, si dhe vështirësitë dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar ata dhe organizata gjatë procesit të hulumtimit.

Raporti është i strukturuar si vijon:

Në **Kapitullin e I-rë** jepet një përshkrim i shkurtër i qëllimit të projektit dhe metodologjisë së hulumtimit. Kjo e fundit përshkruan në detaje secilin hap të hulumtimit, duke filluar nga procesi i ideimit të temave të hulumtimit e deri tek analiza e të dhënave dhe hartimi i rekomandimeve dhe aktiviteve të radhës. Më pas, në kapitull jepet një përmbledhje e rezultateve të secilit grup hulumtues, e strukturuar në bazë të temave të hulumtimit, duke përfshirë edhe një përshkrim të shkurtër të metodologjisë së përdorur dhe numrit të të anketuarve.

Kapitulli i II-të është pjesa kryesore përmbajtësore e raportit e cila përshkruan ecurinë e punës së liderëve të rinj si dhe metodologjinë, gjetjet dhe rekomandimet e nxjerra nga hulumtimi. Secili prej nënkapitujve përbëhet prej komponenteve në vijim: 1. Titulli i temës së hulumtimit; 2. Definicioni i problemit i cili po ashtu përfshin përmbledhje të hulumtimeve dhe literaturës ekzistuese mbi temën përkatëse si dhe politikat, legjislacionin dhe rregulloret ekzistuese që e trajtojnë atë; 3. Metodologjia e hulumtimit e cila përfshin detaje rreth të anketuarve dhe pyetësorit; 4. Gjetjet kryesore të hulumtimit; 5. Arritjet në zhvillimin e kapaciteteve të liderëve të rinj (hulumtuesve) si dhe në aspektin e hulumtimit; 6. Kufizimet dhe sfidat e procesit të punës si dhe grumbullimit dhe analizimit të të dhënave dhe 7. Rekomandimet specifike për trajtimin e problemit në bazë të gjetjeve të hulumtimit.

Në **Kapitullin e III-të** diskutohen arritjet, mësimet e nxjerra dhe ndikimi i hulumtimit, vështirësitë dhe sfidat e punës si dhe rekomandimet e raportit në bazë të gjetjeve të hulumtimit. Arritjet, vështirësitë dhe ndikimi i hulumtimit diskutohen në kuadër të 3 akterëve: liderëve të rinj, organizatës dhe bashkësisë/komunitetit. Ndërkaq, rekomandimet janë të strukturuar si vijon: 1. Çështjet që hulumtimi ngrit në nivel lokal dhe qendror; 2. Roli i organizatës dhe liderëve të rinj; 3. Aktivitetet e menjëhershme/urgjente të avokimit dhe lotimit, dhe 4. Aktivitetet tjera në bazë të temave të hulumtimit.

Më pas, pjesa e **Referencave** përfshin listën e të gjitha punimeve dhe dokumenteve të cilat janë konsultuar dhe cituar brenda në raport, kurse **Shtojca** përmban emrat e liderëve të rinj në bazë të temës që kanë hulumtuar si dhe pyetësorët të cilët janë përdorur për hulumtimin në terren.

QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit është fuqizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve dhe kompetencave të liderëve të rinj (18-26 vjeç) Romë dhe jo-Romë dhe aktivistëve në Ballkanin Perëndimor për të ndërmarrë hapa efektiv në nivel lokal, nacional dhe rajonal për të përmirësuar përfshirjen sociale, mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e Romëve.

Përmes projektit rajonal, 60 liderë të rinj Romë dhe jo-Romë do të fuqizohen për të identifikuar problemet e përbashkëta të përjashtimit social dhe diskriminimit me të cilat ballafaqohen Romët si dhe për të hartuar aktivite të zbatueshme të avokimit për t'i adresuar këto probleme përmes shkëmbimit dhe krijimit të rrjetave të

bashkëpunimit ndër-kufitar, angazhimit të shoqërisë civile dhe avokimit me institucione shtetërore dhe mekanizma ndërkombëtare të cilat trajtojnë çështjet e Romëve.

Liderët e rinj Romë dhe jo-Romë do të punojnë në bashkëpunim me komunitetet e tyre në planifikimin dhe zbatimin e intervenimeve të cilat trajtojnë problemet lokale të cilat shkaktojnë diskriminimin dhe përjashtimin e Romëve. LYRA (Leaders – Young Roma in Action) do t'i zhvilloj shkathtësitë e të rinjve dhe do t'ju ofrojë mundësi për krijimin e rrjetave të bashkëpunimit për identifikimin dhe trajtimin rajonal të çështjeve të ndërlidhura me Romët.

METODOLOGJIA

Në kuadër të projektit, liderët e rinj kanë mbajtur nga gjashtë (6) ditë punëtori lokale mbi temat: “Diskriminimi nga mësimdhënësit”, “Të drejtat e njeriut”, “Stereotipet dhe paragjykimet”, “Pjesëmarrja”, “Fuqizimi i të rinjve” dhe “Studimi me pjesëmarrje”.

Gjatë kësaj kohe, në korridorin e objektit ku është mbajtur trajnimi është vendosur një *flipchart* (letër e madhe e zbrazët) në mur në të cilin të rinjtë kanë mundur të japin ide për temat të cilat ata mendojnë se janë shumë problematike dhe duhet hulumtuar. Ditën e fundit të trajnimit, të gjitha idetë janë mbledhur, prezantuar dhe diskutuar, dhe të rinjtë kanë vendosur se katër (4) problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen komunitet ku ata jetojnë janë: “Braktisja e shkollës” dhe “Martesat e hershme” në Prizren, dhe “Diskriminimi nga mësimdhënësit” dhe “Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor” në Gjakovë.

Siç do të diskutohet më gjerësisht në seksionet e rezultateve të secilit grup të punës, njëri prej problemeve kryesore në analizimin dhe trajtimin e çfarëdo problemi në komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas është mungesa e të dhënave, madje edhe atyre të nivelit nacional. Prandaj, për të kuptuar së pari se a janë të përafërta perceptimet për problemet/temat e zgjedhura të hulumtimit me realitetin apo janë të bazuara vetëm në dëshmi anekdotike, për këtë hulumtim ka qenë e domosdoshme që mostrat të jenë të mëdha dhe statistikisht përfaqësuese të grupit të synuar. Prandaj, në shumicën e rasteve (përveç për temën e Grupit të Punës IV), anketimi është zhvilluar me dy grupe: grupin e synuar (fëmijët apo të rinjtë) dhe prindërit nga të cilët është kërkuar të japin informacione për të gjithë fëmijët e tyre.

Duke marrë parasysh që temat janë të ndryshme dhe përfshijnë të anketuar të shumëllojshëm (prindër, fëmijë, institucione), si instrumente të hulumtimit janë përzgjedhur anketat në mënyrë që të rinjve t'iu japin mundësinë të zhvillojnë shkathtësitë e hulumtimit në terren si dhe të njihen më mirë me bashkësinë/komunitetin, e cila do t'ju lehtësojë më pas zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

Sa i përket procesit të hartimit të pyetësorëve, të udhëhequr nga konsulenti i angazhuar për analizën e hulumtimeve dhe shkrimin e raportit nacional, liderët e rinj janë takuar disa herë për të diskutuar dhe vendosur për pyetjet të cilat do të vendosen në pyetësor si dhe grupet e të anketuarve që duhen intervistuar për tu siguruar që mostrat janë të mëdha. Kjo e fundit është posaçërisht e rëndësishme për të nxjerrë përfundime që janë statistikisht domethënëse dhe që mund të përdoren për hartim të aktiviteteve që do të ndërmerren nga të rinjtë në të ardhmen e afërt.

Para se hulumtimi të fillojë në terren, pyetësorët janë pilotuar dhe testuar në bashkësitë ku është planifikuar të bëhet hulumtimi, Gjakovë dhe Prizren. Më pas, liderët dhe vullnetarët e secilit grup i kanë diskutuar në mes veti problemet me anketim dhe me pyetje, dhe pyetësorët janë modifikuar nga liderët në bashkëpunim me konsulentin për të mundësuar grumbullimin e informatave sa më të qarta, për të lehtësuar punën e intervistuesve (liderëve të rinj dhe vullnetarëve) si dhe për të lehtësuar përfshirjen e të dhënave në baza të të dhënave.

Hulumtimi në terren ka zgjatur gjithsej 15 ditë për secilin grup. Secili grup i punës është përbërë nga pesë (5) lider të rinj dhe dy (2) vullnetarë. Në mënyrë që mostrat të jenë sa më përfaqësuese të popullsisë së synuar, respondentët e mostrës janë përzgjedhur sipas metodës së rastit , me ç'rast anketuesit kanë intervistuar familjet në çdo të tretën shtëpi në lagjet ku i kanë zhvilluar anketat si dhe fëmijët të cilët i kanë takuar në oborret e shkollave fillore dhe të mesme. Duhet theksuar se për temën e hulumtimit *Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor*, për shkak të problemeve me identifikimin e këtyre fëmijëve dhe hezitimin e prindërve që të anketohen, mostra është përzgjedhur nga baza e të dhënave të përfituesve të organizatave HandiKOS dhe One-to-One, të cilat ofrojnë shërbime për këta fëmijë nëpër komuna të ndryshme anembanë Kosovës. Gjithashtu, për po të njejtën temë, Grupi i Punës IV ka intervistuar edhe drejtuesit e shkollave fillore të Gjakovës në mënyrë që hulumtimi të jetë më i kompletuar sa i përket identifikimit të barrierave të qasjes në arsimim për fëmijët me nevoja të veçanta.

Pas përfundimit të hulumtimit, të dhënat janë futur në bazat e të dhënave, janë analizuar dhe gjetjet e secilës temë të hulumtimit janë diskutuar me të rinjtë e secilit grup të punës në kuadër të të drejtave të njeriut, ndër-sektorialitetit dhe akterëve përkatës. Pas këtyre diskutimeve, të rinjtë së bashku me anëtarët e organizatave kanë propozuar rekomandime për aktivitetet e menjëhershme që duhen ndërmarrë në bashkësi për të trajtuar problemet e hulumtuara.

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË GRUPEVE HULUMTUESE

BRAKTISJA E SHKOLLËS

Grupi i Punës i ka mbledhur informata nga gjithsej 294 fëmijë të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas të moshës shkollore (6-22 vjeç) në komunën e Prizrenit, 139 prej të cilëve janë intervistuar drejtpërdrejtë, ndërsa për të tjerët informatat janë mbledhur duke intervistuar 171 prindër. Gjetjet kryesore të këtij hulumtimi janë si vijon:

- Braktisja e shkollës nga fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas është ende problematike në komunën e Prizrenit. Rreth 16% e fëmijëve të anketuar kanë thënë se aktualisht nuk janë duke e vijuar mësimin;
- Braktisja e shkollës është më e evidente në mesin e vajzave në krahasim me moshatarët e tyre djem: afërsisht 19% e vajzave të përfshira në anketë nuk janë duke e vijuar mësimin në krahasim me 13.8% të djemve të moshës shkollore;
- Braktisja e shkollës është kryesisht afat-gjatë apo e përhershme: nga 28 të anketuar të cilët i janë përgjigjur pyetjes se kur e kanë braktisur shkollën, më shumë se gjysma (18) kanë raportuar se e kanë ndërprerë mësimin para 2 apo më pak vitesh, ndërsa të tjerët para një kohe më të gjatë;
- Edhe pse arsyet e braktisjes së shkollës janë të shumëfishta, arsyeja kryesore raportohet të kenë qenë kushtet e vështira financiare (52%). Dyzet përqind (40%) e fëmijëve e kanë braktisur shkollën në mes tjerash për shkak të kushteve të vështira financiare, kurse 12% edhe për arsye se iu është dashur të punojnë. Diskriminimi në sistemin shkollore (qoftë i drejtpërdrejtë apo jo) po ashtu raportohet se luan rol në braktisjen e shkollës: 13% e fëmijëve dhe prindërve kanë përmendur diskriminimin si faktor në braktisje të shkollës, 5% faktin që nuk janë ndier mirë në mesin e fëmijëve tjerë, ndërsa 5% për shkak të mësimdhënësve. Dymbëdhjetë përqind (12%) e fëmijëve kanë përmendur edhe vështirësitë me gjuhën si njëri ndër arsyet që e kanë braktisur shkollën, ndërsa vetëm një (1) prej tyre ka thënë se e ka braktisur shkollën për shkak se është martuar;
- Zhvillimi i aftësive apo shkathtësive pas braktisjes së shkollës është po ashtu problematik dhe e vështirëson qasjen e të rinjve në treg të punës edhe më shumë: vetëm 9 prej 40 fëmijëve (22.5%) të cilët e kanë braktisur shkollën kanë raportuar të kenë ndjekur ndonjë kurs apo trajnim dhe vetëm 2 prej tyre kanë vijuar kurs që nuk është i lidhur me ndonjë zanat, atë të gjuhës angleze.

MARTESAT E HERSHME

Grupi i Punës II ka mbledhur informata për gjithsej 217 të rinj të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në komunën e Prizrenit, 109 prej të cilëve janë intervistuar drejtpërdrejtë, ndërsa për pjesën tjetër të dhënat janë mbledhur duke intervistuar prindër më të moshuar të këtyre komuniteteve. Gjetjet kryesore të këtij hulumtimi janë si vijon:

- Martesat e hershme perceptohen dhe ende janë të përhapura në mesin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Më shumë se gjysma e të rinjve dhe prindërve të anketuar (63%) mendojnë se martesat e hershme janë ende evidente në lagjen apo komunën e tyre;
- Afërsisht 34% e të rinjve të intervistuar janë martuar nën moshën 18 vjeçare;
- Dallimet gjinore në martesat e hershme vazhdojnë të jenë drastike: rreth 65% e të anketuarve që janë martuar para moshës 18 vjeç janë femra, kurse 35% meshkuj;
- Vetëm gjysma e të rinjve kanë vendosur vet apo së bashku me partnerin/partneren e tyre se duan të martohen (54%). Për 22% e të rinjve të cilët janë martuar nën moshën 18-vjeç të dy prindërit kanë vendosur se ai/ajo duhet të martohet, për 8% ka vendosur e tërë familja, për 5% babai, për 5% gjyshi, e kështu me radhë;
- Në pyetjen se përse martesat e hershme ende ndodhin në komunitetin e tyre, të rinjtë kanë radhitur arsyet në vijim si më të rëndësishmet: gjendja ekonomike (22% e të anketuarve), mentaliteti apo mosdija (20%), traditat dhe zakonet (15% e të anketuarve), dashuria (15% e të anketuarve), vetëdëshira (8% e të anketuarve), rritja e numrit të anëtarëve të familjes (3%), etj.
- Megjithatë, kur janë pyetur për veten e tyre, shumica e të rinjve të cilët janë martuar para moshës 18 vjeç (67.7%) kanë thënë se janë martuar nga dashuria, 24.3% për shkak të traditave apo zakoneve, 2.7% për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe 5.4% për shkak të problemeve në familje;
- Shumë pak të rinj të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, e sidomos ata që martohen para moshës 18-vjeçare, i zyrtarizojnë martesat e tyre ligjërisht / i regjistrojnë në komunë, që është faktikisht hapi i parë drejtë trajtimit të kësaj problematike. Rreth 92% e të rinjve të intervistuar (91.7%) nuk janë kurorëzuar në komunë kur janë martuar, ndërsa vetëm 40.7% prej tyre kanë raportuar se posedojnë certifikatë të martesës, pra janë kurorëzuar më vonë.

DISKRIMINIMI NGA MËSIMDHËNËSIT

Grupi i Punës III ka mbledhur informata për gjithsej 346 fëmijë dhe të rinj të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas të moshës (5-20 vjeç) në komunën e Gjakovës, 149 prej të cilëve janë intervistuar drejtpërdrejtë, ndërsa për pjesën tjetër të dhënat janë mbledhur duke intervistuar prindërit në këto komunitete të cilët kanë fëmijë të moshës shkollore. Gjetjet kryesore të këtij hulumtimi janë si vijon:

- Diskriminimi i drejtpërdrejtë i fëmijëve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas nga mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme në Gjakovë perceptohet të mos jetë shumë i përhapur. Vetëm 7 nga 149 fëmijët e intervistuar drejtpërdrejtë (4.7%) kanë pohuar se mësimdhënësit sillen ndryshe me ta në krahasim me nxënësit tjerë; 5 prej tyre (3.4%) kanë thënë se mësimdhënësit nuk iu përgjigjen kur ata nuk kanë diçka të qartë gjatë orës së mësimi; 6 prej tyre (4.03%) kanë thënë se mësimdhënësit nuk i pyesin para tabelës sikur fëmijët tjerë, ndërsa vetëm njëri prej fëmijëve të anketuar ka thënë se mësimdhënësit nuk ia kontrollojnë detyrat rregullisht;
- Diskriminimi nga mësimdhënësit dhe sistemi shkollor është më prezent në aspekte dhe aktivitete tjera që organizohen jashtë orarit të mësimi. Rreth 34% e të gjithë fëmijëve të përfshirë në anketim (367) nuk marrin pjesë në orët shtesë të gjuhës shqipe, gjuhës angleze, matematikës, etj., të cilat organizohen në shkollë, ndër-

sa 47.1% nuk marrin pjesë në aktivitete tjera shkollore siç janë kuizet, garat shkollore, aktivitetet sportive, kori i shkollës, koncertet, etj.

- Edhe pse një përqindje relativisht e lartë e fëmijëve dhe prindërve kanë zgjedhur mosorganizimin e aktiviteteve dhe mospërzgjedhjen nga mësimdhënësit si arsye kryesore për mospjesëmarrje në aktivitetet e lartpërmendura, mosinteresimi, mosdëshira dhe mosinformimi i fëmijëve janë çështje që duhet hulumtuar patjetër në të ardhmen sepse mund të jenë indikatorë edhe më të mirë/fuqishëm të diskriminimit në sistemin shkollor;
- Së fundi, gjetjet se më shumë se gjysma e fëmijëve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas (58.2%) ulen me shokë/shoqe të komunitetit të njejtë në bankë dhe se 90% prej tyre shoqërohen me fëmijë të komunitetit të njejtë pas orarit të mësimi janë indikator mjaft të fuqishëm se sistemi shkollor duhet të punoj më shumë në integrimin e këtyre fëmijëve.

PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SISTEMIN SHKOLLOR

Grupi i Punës IV ka mbledhur informata për gjithsej 205 fëmijë me nevoja të veçanta në komunën e Gjakovës dhe përfshirjen e tyre në sistem shkollor duke intervistuar prindërit e tyre si dhe 6 shkolla fillore: Fehmi Agani, Mazllum Këpuska, Zekri Rexha, Zef Lush Marku, Selman Riza dhe Mustafa Bakija. Respondentët e anketës janë përzgjedhur duke përdorur regjistrat e përfituesve të organizatave HandiKOS dhe One-to-One të cilat ofrojnë shërbime për këtë grup fëmijësh. Gjetjet kryesore të këtij hulumtimi përfshijnë:

- Pak më shumë se gjysma e fëmijëve të anketuar (67%) vijojnë mësimin në shkolla fillore apo të mesme;
- Edhe pse shumica e prindërve kanë raportuar se fëmijët e tyre nuk e vijojnë mësimin për arsye të shumëfishta, mungesa e asistentit personal përmendet si një ndër arsyet kryesore nga 48% e të anketuarve. Rreth 25% e prindërve kanë thënë se njëra ndër arsyet përse fëmijët e tyre nuk janë duke e vijuar mësimin është sepse nuk është pranuar nga pedagogu/drejtori i shkollës ku ka aplikuar; 10% kanë përmendur kushtet ekonomike si një ndër arsyet kryesore, kurse 8% e prindërve kanë përmendur mungesën e infrastrukturës (qasjes fizike) brenda dhe jashtë shkollës dhe mungesën e teksteve shkollore (për fëmijët e verbër) si disa nga arsyet përse fëmijët e tyre nuk e vijojnë mësimin;
- Sa i përket shkollave të intervistuar, në 6 prej tyre mësimi për fëmijët me nevoja të veçanta ofrohet vetëm në klasa të rregullta, në njërin edhe në klasa të rregullta edhe të ndara/speciale, kurse në shkollën e fundit vetëm në klasa të ndara/speciale;
- Ndërkaq, sa i përket qasjes fizike nëpër shkolla, të dhënat tregojnë se nga 5 shkollat ku fëmijët me nevoja të veçanta e ndjekin mësimin, në 3 prej tyre ka qasje horizontale, do të thotë qasje në klasat dhe dhomat e katit të parë për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike, ndërsa vetëm në njërin prej tyre këta fëmijë kanë qasje vertikale, pra në katet tjera të objektit të shkollës;
- Vetëm njëra (1) nga pesë (5) shkollat ku fëmijët me nevoja të veçanta e vijojnë mësimin ka asistentë personal për këta fëmijë.

KAPITULLI 2

REZULTATET E GRUPIT I

BRAKTISJA E SHKOLLËS**PROBLEMI**

E drejta për arsimim konsiderohet si njëra ndër të drejtat kryesore dhe themelore të njeriut. Arsimiti është njëri ndër faktorët kryesor që ka ndikim dhe siguron zhvillimin e qëndrueshëm të secilit shtet. Prandaj, edhe në Kosovë si në të gjitha vendet tjera, përfundimi i shkollimit obligativ (shkollimit fillor) dhe zvogëlimi i nivelit të braktisjes së shkollës është njëri ndër prioritetet kryesore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Megjithatë, problemet dhe sfidat janë të shumëfishta, duke filluar nga problemi i mbledhjes së të dhënave për monitorim deri tek kufizimet buxhetore të qeverisë. Edhe pse ekziston perceptim i përbashkët i opinionit publik se grupet e marginalizuara, si për shembull gjinia femërore, të varfrit dhe komunitetet pakicë, kanë më shumë probleme me qasje dhe përfundim të shkollimit, shumë pak të dhëna zyrtare janë mbledhur për t'iu qasur këtij problemi në mënyrë konstruktive.

Raporti i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për “Braktisjen e shkollës dhe mosvijimin e mësimi”² tregon se të dhënat zyrtare për braktisjen e shkollës janë të mangëta dhe të pasigurta (OSBE, 2012). Ndër problemet kryesore të përmendura në lidhje me grumbullimin e këtyre të dhënave janë: mosgrumbullimi i të dhënave mbi braktisjen e shkollës, mospërputhja e të dhënave të grumbulluara nga shkollat në krahasim me ato të drejtorive të arsimit në nivel komunal, mosgrumbullimi i të dhënave mbi arsyet e braktisjes së shkollës dhe pamundësia e ndarjes së të dhënave ekzistuese sipas gjinisë dhe etnisë apo komunitetit.

Sipas Doracakut për Zyrtarë Komunal “Përmirësimi i ofrimit të arsimit për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas (RAE): Praktikë më të mira dhe Rekomandimet” i përgatitur nga Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI – European Centre for Minority Issues) – bazuar në implementimin e projektit me po këtë emër në Fushë Kosovë, mosvijimi i mësimi dhe braktisja e shkollës nga fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas ndodh kryesisht për shkak të përjashtimit ekonomik-social, marginalizimit dhe shkallës së lartë të varfërisë në mesin e këtyre komuniteteve. Sipas këtij raporti, braktisja e shkollës është posaçërisht e shpeshtë në shkollën fillore (klasa e 5-të apo 6-të) dhe fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas zakonisht nuk e vijnë shkollimin e mesëm. Raporti gjithashtu konstaton se shkalla e braktisjes së shkollës është shumë e lartë për vajzat si rezultat i martesave të hershme dhe roleve tradicionale gjinore (ECMI, 2012).

Siç mund të kuptohet nga përmbledhja e këtyre dy raporteve, përkundër perceptimit të përgjithshëm të shpeshtësisë së braktisjes së shkollës dhe mosvijimit të mësimi nga fëmijët e komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptas, shumë pak të dhëna dhe informata ekzistojnë mbi përhapjen dhe shpeshtësinë aktuale të kësaj dukurie, shkaqet, arsyet e karakteristikat tjera demografike e socio-ekonomike. Duke marrë parasysh rëndësinë e arsimit në përfshirje socio-ekonomike, përmes këtij hulumtimi qëllimi i **Grupit I** ka qenë të kuptojë shumë-dimensionalitetin e braktisjes së shkollës dhe mosvijimit të mësimi nga fëmijët e moshës së shkollës fillore dhe të mesme.

2 Raporti “Braktisja e shkollës dhe mosvijimi i mësimi” është i bazuar në hulumtimin e OSBE-së në vitin 2011 i cili ka përfshirë intervista me drejtorë të 83 shkollave fillore dhe të mesme në 24 komuna të Kosovës si dhe me drejtorë komunal të arsimit, studentë, përfaqësues të MASHT-it dhe organizata tjera lokale dhe ndërkombëtare të angazhuara në fushën e arsimit.

METODOLOGJIA

Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave mbi këtë problematikë si dhe kohën dhe hapësirën e kufizuar gjeografike, anketa është zhvilluar me dy grupe respondentësh: fëmijët e moshës shkollore dhe prindërit të cilët kanë fëmijë të moshës shkollore. Kjo qasje ka mundësuar jo vetëm grumbullimin e më shumë të dhënave (për t'i bërë përfundimet jo vetëm më të sakta por edhe më të besueshme) por edhe krahasimin në perceptime në mes të këtyre dy grupeve rreth braktisjes së shkollës dhe mosvijimit të mësimit.

Për të marrë informata për sa më shumë aspekte të braktisjes së shkollës, anketa ka grumbulluar informata rreth:

- karakteristikave demografike të fëmijëve: gjinia dhe mosha;
- vijimit të shkollës: klasa të cilën janë duke e vijuar, gjuha në të cilën janë duke e vijuar mësimin, rregullsia e vijimit të mësimit dhe numri dhe arsyeja e mungesave në 3 muajt e fundit; si dhe
- braktisjes së shkollës: kohëzgjatja e braktisjes, klasa kur e kanë braktisur shkollën, arsyet e braktisjes, aktivitetet pas braktisjes së shkollës dhe planet dhe arsyet për vazhdim apo mosvazhdim të shkollimit.

Duhet theksuar që edhe fëmijët të cilët kanë qenë duke vijuar mësimin në kohën e anketimit janë pyetur në qoftë se e kanë braktisur shkollën ndonjëherë në mënyrë që të merren informata edhe për braktisjet e përkohshme të shkollës.

GJETJET KRYESORE

Anketa “Braktisja e shkollës” ka mbledhur informata për gjithsej 294 fëmijë dhe të rinj të moshës shkollore 6-22 vjeç. Anketa ka intervistuar drejtpërdrejtë 139 fëmijë dhe 171 prindër të fëmijëve të moshës shkollore. Me përfshirjen e prindërve në anketë është mundësuar grumbullim i informatave për një mostër mjaft të madhe të fëmijëve, gjë që mundëson pasqyrë më të qartë të situatës e cila është edhe statistikisht e saktë. Për të kapur informata sa më të larmishme dhe për të siguruar që mostra të jetë e madhe, anketa është zhvilluar në katër lagje të komunës së Prizrenit: “Jeta e Re”, “Ortakoll”, “Xheladin Hana” dhe “Bazhdarhane”.

Disa nga gjetjet kryesore të anketës janë si vijon:

- 16% e fëmijëve nuk janë duke e vijuar mësimin;
- Numri i vajzave të cilat e kanë braktisur shkollën është pak më i lartë se ai i djemve. Afërsisht 19% e vajzave të përfshira në anketë nuk janë duke e vijuar mësimin në krahasim me 13.8% të djemve të moshës shkollore;
- Shumica e fëmijëve/të rinjve të cilët e kanë braktisur shkollën nuk e kanë vijuar mësimin vitin e kaluar shkollor (2012-2013), që do të thotë se shumica e fëmijëve e kanë braktisur shkollën për kohë më të gjatë. Vetëm 11 nga 48 fëmijët e moshës shkollore të cilët e kanë braktisur shkollën e kanë vijuar mësimin gjatë vitit të kaluar shkollor;
- Nga të dhënat nuk mund të përcaktohet ndonjë trend i përgjithshëm i braktisjes së shkollës për sa i përket klasës kur fëmijët e kanë ndërprerë vijimin e mësimit. Gjashtë (6) nga 41 të anketuar të cilët janë përgjigjur në këtë pyetje e kanë braktisur shkollën në klasën e 9-të (pas përfundimit të shkollës së ulët të mesme), 6 pas klasës së 7-të, 5 pas klasës së 8-të, 4 pas klasës së 3-të, 4 pas klasës së katërt e kështu me radhë;

- Nga 28 të anketuar të cilët i janë përgjigjur pyetjes se kur e kanë braktisur shkollën, një numër shumë i madh (18) kanë raportuar se e kanë ndërprerë mësimin para 2 apo më pak vitesh, ndërsa të tjerët për kohë më të gjatë;
- Shumica e fëmijëve apo të rinjve e kanë braktisur shkollën për arsye të shumëfishta. Megjithatë arsyeja kryesore raportohet të kenë qenë kushtet e vështira financiare (52%). Dyzet për qind (40%) e fëmijëve e kanë braktisur shkollën në mes tjerash për shkak të kushteve të vështira financiare, kurse 12% edhe për arsye se iu është dashur të punojnë. Të dhënat e anketës po ashtu tregojnë se diskriminimi (edhe nëse nuk është i drejtpërdrejtë) është faktor i rëndësishëm në vijimin e mësimin. Për 13% të fëmijëve diskriminimi ka qenë njëra ndër arsyet kryesore pse e kanë braktisur shkollën, përderisa 5% kanë thënë se nuk janë ndier mirë në mesin e fëmijëve tjerë dhe 5% për shkak të mësimdhënësve. Dymbëdhjetë për qind (12%) e fëmijëve kanë përmendur edhe vështirësitë me gjuhën si një ndër arsyet që e kanë braktisur shkollën. Përderisa 4 prej fëmijëve kanë përmendur përkujdesjen për motrat/vëllezërit e tyre si një ndër arsyet përse e kanë braktisur shkollën, vetëm një prej tyre ka raportuar ta ketë ndërprerë vijimin e mësimin për shkak të martesës;
- Vetëm 9 prej 40 fëmijëve (22.5%) të cilët e kanë braktisur shkollën kanë raportuar të kenë ndjekur ndonjë kurs apo trajnim dhe vetëm 2 prej tyre kanë vijuar kurs që nuk është i lidhur me ndonjë zanat, kursin e gjuhës angleze;
- Vetëm 10 prej 41 fëmijëve/të rinjve (24.4%) planifikojnë të kthehen në shkollë në të ardhmen;
- Sikurse arsyeja e braktisjes së shkollës, shumica e fëmijëve/të rinjve nuk planifikojnë të kthehen në shkollë për arsye të shumëfishta. Kushtet e vështira ekonomike mbeten arsyeja kryesore për mosvijim të mësimin. Tridhjetë e pesë për qind (35%) e fëmijëve/të rinjve nuk planifikojnë të kthehen në shkollë për shkak të kushteve të vështira ekonomike, ndërsa 16% kanë raportuar se arsyeja kryesore pse nuk vazhdojnë shkollimin është për shkak se iu duhet të punojnë. Për 19%, njëra ndër arsyet pse nuk mund të vazhdojnë shkollimin është përkujdesja për vëllezërit dhe motrat, ndërsa për 14% njëra ndër arsye kryesore është se do të martohen;
- Vetëm 2 (1.9%) prej 103 fëmijëve të cilët janë duke e vijuar shkollimin momentalisht kanë thënë që nuk e vijnë mësimin rregullisht;
- Vetëm 8 nga 257 fëmijët të cilët janë duke e vijuar mësimin aktualisht (3.1%) e kanë braktisur shkollën përkohësisht në të kaluarën për një periudhë kohore prej mesatarisht një viti;
- Sikurse me braktisjen afatgjatë të shkollës, arsyeja kryesore për braktisjen e përkohshme të shkollës raportohet të jenë kushtet e vështira ekonomike; 4 nga 10 fëmijët/të rinjtë.

ARRITJET

Sa i përket procesit të punës së të rinjve, njëra ndër arritjet kryesore ka qenë dizajnimi i metodologjisë më të përshtatshme e cila do të siguronte grumbullimin e të dhënave për mostër përfaqësuese të fëmijëve dhe të rinjve. Gjithashtu, procesi i hartimit të pyetësorit i ka shtyrë të rinjtë (intervistuesit) të mendojnë për mënyrat e ndryshme se si mund të merren informata sa më gjithëpërfshirëse rreth një teme të caktuar dhe gjithashtu të mendojnë për aspektet e shumëfishta dhe shumëllojshme të një problemi. Për këtë arsye, përveç braktisjes së përhershme të shkollës, të anketuarit (fëmijët dhe të rinjtë të cilët janë duke e vijuar mësimin aktualisht) janë pyetur nëse e kanë braktisur shkollën ndonjëherë. Njëra ndër arritjet më kyçe të këtij grupi ka qenë përshtatja e mënyrës së intervistimit varësisht prej natyrës dhe karakteristikave të të anketuarit, në këtë rast, dallimi në intervistim në mes të prindërve dhe vet fëmijëve. Kjo sfidë nuk e ka mundur vetëm zhvillimin individual të kapaciteteve të të rinjve por edhe shkathtësitë e tyre për punë ekipore duke i nxitur të bashkëpunojnë në

mes vete, duke shkëmbyer ide se cilat praktika dhe metoda funksionojnë më së miri në intervistimin e grupit të caktuar të anketuarve. Për më tepër, kontakti me komunitetin dhe diskutimi i kësaj problematike edhe me fëmijët edhe me prindërit iu ka hapur të rinjve diapazonin rreth shumë-dimensionalitetit të problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas në fushën e qasjes në arsim.

Për sa i përket arritjeve në aspektin e të dhënave të grumbulluara, hulumtimi “Braktisja e shkollës” do të kontribuojë në shënimet ekzistuese mjaft shumë, posaçërisht sa i përket zgjidhjes së këtij problemi në nivelin lokal, në Prizren. Së pari, gjetjet e anketës tregojnë se sa është evidente dhe e përhapur braktisja e shkollës nga fëmijët Romë, Ashkali dhe Egjiptian në këtë komunë. Së dyti, gjetjet e anketës vënë në pah dallimet gjinore në braktisjen e shkollës, arsyet kryesore të braktisjes së shkollës dhe arsyet pse fëmijët/të rinjtë nuk kthehen më në sistemin shkollor dhe si ballafaqohen me braktisjen e shkollës. Të gjitha këto informata nuk janë të dobishme vetëm për identifikimin e shkaqeve të braktisjes së shkollës, por edhe jashtëzakonisht të rëndësishme për të informuar të gjithë akterët se si duhet qasur këtij problemi si dhe mbajtjes së fëmijëve në sistem shkollor.

KUFIZIMET DHE SFIDAT E HULUMTIMIT

Kufizimi i parë i këtij hulumtimi është mungesa e të dhënave në fushën e braktisjes së shkollës e cila nuk pamundëson jo vetëm vlerësimin e situatës (nëse është përmirësuar apo përkeqësuar) por edhe vlefshmërinë e të dhënave të grumbulluara. Së dyti, grumbullimi i të dhënave vetëm në komunën e Prizrenit e kufizon trajtimin e problemit vetëm në këtë komunë. Së fundi, duke pasur parasysh përvojën e kufizuar të të rinjve në hulumtime në terren si dhe kohën e shkurtër për të cilën është kryer hulumtimi, shumë çështje dhe aspekte të ndërlidhura me braktisjen e shkollës nuk janë përfshirë në pyetësor, gjë që kufizon rekomandimet për trajtim më gjithëpërfshirës të problemit.

REKOMANDIMET

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se faktorët të cilët ndikojnë në braktisjen e shkollës janë të shumëllojshëm dhe shumëfishtë, prandaj edhe trajtimi i këtij problemi duhet të fokusohet në shumë dimensione të cilat përfshijnë akterë nga fusha të ndryshme.

Së pari, gjetja se nuk ekziston ndonjë trend i caktuar se kur e braktisin shkollën fëmijët/të rinjtë dëshmon se çfarëdo përpjekje apo aktiviteti duhet të fokusohet në fëmijët/të rinjtë e të gjitha grupmoshave dhe niveleve të shkollimit.

Pastaj, duke pasur parasysh faktin se fëmijët/të rinjtë e braktisin shkollën për shkak të arsyeve të shumëfish-ta - kushtet e vështira ekonomike, diskriminimi në shkollë, përkujdesja për motrat dhe vëllezërit më të vegjël, vështirësitë me gjuhën në shkollë, etj., - çfarëdo projekti/aktiviteti duhet patjetër të fokusohet në disa sektore (sistemin e mbrojtjes sociale, sistemin e punës dhe punësimit, sistemin e arsimit); në nivele të ndryshme të qeverisjes (ministrinë në nivel qendror dhe komunat, drejtorinë dhe shkollat në nivel lokal) dhe të jetë gjithëpërfshirës sa i përket pjesëmarrjes së akterëve (zyrtarët në ministrinë përkatëse, drejtorët komunal për arsim, punëtorët e Qendrave për Punë Sociale (QPS), zyrtarët komunal për komunitete, drejtorët e shkollave, mësimitdhënësit, prindërit, nxënësit, organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe mediat).

Së fundi, në rastet kur vijimi i shkollës është i vështirë / i pamundur, duhen patjetër të krijohen mekanizma dhe të ofrohen mundësi që të rinjtë të aftësohen në zanate apo profesione të cilat do ta lehtësonin përfshirjen e tyre në treg të punës dhe do t’u siguronin të ardhura.

REZULTATET E GRUPIT II

MARTESAT E HERSHME**PROBLEMI**

Martesa e fëmijëve apo martesa e hershme definohet si bashkim i dy personave, së paku njëri prej të cilëve është nën moshën 18-vjeçare. Fakti që së paku njëri nga këta dy persona është fëmijë (edhe sipas Ligjit të Kosovës për Familjen Nr. 2004/32) do të thotë se martesat e hershme janë shkelje e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të njeriut sepse fëmijët nuk e kanë zotësinë për të vepruar dhe dhënë pëlqimin apo vendosur për t'u martuar.

Sipas dokumentit të UNFPA-së mbi “Martesat e Fëmijëve” (2012), martesat e hershme janë ende mjaft të përhapura në Kosovë, sidomos në mesin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Kjo dukuri është posaçërisht e evidente në zonat rurale ku vajzat konsiderohen të jenë të gatshme për martesë qysh në moshën 13-15 vjeç (UNFPA, 2012). Raporti i hulumtimit i publikuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) (2009) i cili vlerëson gjendjen e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë përmes anketës me 857 të anketuar po ashtu radhit martesat e hershme si një prej problemeve me të cilat ballafaqohen këto komunitete. Shumica e të anketuarve të moshës 18+ vjeç (85.6%) kanë raportuar të jenë apo të kenë qenë të martuar (KFOS, 2012, f.84). Raporti i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore dhe Rrjetit të Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase mbi gjendjen e vajzave dhe grave të këtij komuniteti (pa datë) përmend se mosha mesatare e martesës së vajzave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas është 15-16 vjeç, ndërsa ajo e djemve 18 vjeç apo më shumë (KCGS & RROGRAEK, p.d., faqe 13).

Përkundër mungesës së hulumtimeve, raportet e lartpërmendura radhisin dashurinë, presionin e familjes, gjendjen socio-ekonomike si dhe traditat dhe zakonet e mëhershme si arsye për martesa të hershme, ndërkaq dhuna në familje, ndarjet, shtatzënitë e padëshirueshme, komplikimet e shtatzënisë, braktisja e shkollës dhe problemet me punësim radhiten si pasoja të zakonshme (UNFPA, 2012). Edhe pse që të dyja palët - edhe vajzat edhe djemtë e rinj – zakonisht braktisin shkollën për t'u punësuar apo përkuqdesur për familje dhe për t'i kryer punët në shtëpi pas martesës, martesat e hershme kanë ndikim shumë më negativ te vajzat e reja. Kjo për arsye se martesat e hershme janë më të shpeshta në mesin e vajzave të reja (nën moshën 18-vjeç), gjë që ua dobëson apo pamundëson atyre vendimmarrjen në familje, duke i rrezikuar kështu edhe nga dhuna edhe nga keqpërdorimet seksuale. Fakti që martesat e hershme vazhdojnë të neglizhohen apo injorohen nga autoritetet zyrtare për shkak se konsiderohen të jenë thellë të ngulitura në traditat e mëhershme të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, e bën këtë çështje edhe më të vështirë për t'u trajtuar në mënyrë të përshtatshme dhe efektive nga institucionet zyrtare dhe organizatat jo-qeveritare.

Duke marrë parasysh që komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas shumë rrallë i regjistrojnë martesat e tyre në përgjithësi, e veçanërisht martesat e hershme, ky hulumtim ka për qëllim të grumbullojë të dhëna mbi praninë dhe përhapjen e martesave të hershme si dukuri, shkaqet kryesore përse ato ndodhin, si perceptohen nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas si dhe si janë të ndërlidhura me qasjen në arsimim dhe me braktisje të shkollës.

METODOLOGJIA

Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave mbi këtë problematikë si dhe kohën dhe hapësirën e kufizuar gjeografike ku të rinjtë kanë mundur të intervistojnë, anketa është zhvilluar me dy grupe të anketuarish: prindërit të cilët kanë fëmijë adoleshentë apo të moshës madhore dhe vet të rinjtë. Kjo qasje ka mundësuar jo vetëm në grumbullimin e më shumë të dhënave (për t'i bërë përfundimet jo vetëm më të sakta por edhe më të besueshme) por edhe krahasimin në perceptime në mes të këtyre dy grupeve rreth martesave të hershme.

Për të marrë informata për sa më shumë aspekte të martesave të hershme, anketa ka grumbulluar informata rreth:

- karakteristikave demografike të të rinjve dhe partnerëve të tyre: gjinia, mosha, niveli i arsimit, niveli i shkollimit të prindërve;
- rrethanave të familjeve në të cilat janë të rritur të rinjtë: sjellja e prindërve në shtëpi, vendimmarrja dhe gjendja financiare;
- martesës së të rinjve: mosha e tyre dhe e partnerëve kur janë martuar, regjistrimi i martesës, niveli i shkollimit para dhe pas martesës, braktisja e shkollës, vendimmarrësi(t) për martesë, arsyet e martesës dhe mendimet e të tjerëve rreth martesës; dhe
- perceptimet për martesat e hershme: mendimet e të tjerëve për martesat e hershme, përhapja e martesave të hershme dhe arsyet për martesat e hershme.

Duhet theksuar që prindërit e të rinjve janë pyetur për martesën e të gjithë fëmijëve të tyre në mënyrë që të vihen në pah dallimet gjinore në këtë dukuri.

GJETJET KRYESORE

Anketa “*Martestat e hershme*” ka mbledhur informata për gjithsej 217 të rinj, 109 prej të cilëve janë intervistuar drejtpërdrejtë nga të rinjtë e angazhuar në projekt, ndërsa për 108 prej të tjerëve informatat janë marrë duke intervistuar prindërit e tyre. Të rinjtë e intervistuar janë të moshës 15-37 vjeç, ndërsa prindërit 32-73 vjeç. Me përfshirjen e prindërve në mostër është mundësuar mbledhja e informatave për më shumë të rinj në mënyrë që rezultatet e anketës të jenë statistikisht të rëndësishme dhe të mund të përdoren për të hartuar dhe planifikuar aktivitete për t'i trajtuar martesat e hershme në bashkësinë ku janë zhvilluar intervistat.

Për të kapur informata sa më të larmishme dhe për të siguruar që mostra të jetë e madhe, anketa është zhvilluar në shtatë (7) lagje të komunës së Prizrenit: “Hasan Prishtina”, “Jeta e Re”, “Landovicë”, “Ramadan Çeku”, “Selajdin Berisha”, “Terzi Mahall”, dhe “Xheladin Hana”.

Disa nga gjetjet kryesore të anketës mbi martesat e hershme janë si vijon:

- Rezultatet e anketës tregojnë se të rinjtë e intervistuar kanë nivel mjaft të ulët të shkollimit. Pak më shumë së 32% e të rinjve të intervistuar nuk kanë përfunduar arsimin obligativ (11% prej tyre janë analfabet, ndërsa 20.2% dijnë shkrim dhe lexim edhe pse nuk kanë përfunduar ndonjë shkollë), 44% kanë përfunduar shkollën fillore, 20.2% kanë përfunduar shkollën e mesme dhe vetëm 3.7% (apo 4 prej 109 të anketuarve) kanë përfunduar universitetin;

- Mosha mesatare e martesës së të rinjve të intervistuar është 18.8 vjeç, mosha më e ulët 14 vjeç, ndërsa ajo më e larta 28 vjeç. Afërsisht 34% e të rinjve të intervistuar janë martuar nën moshën 18 vjeçare. Siç kanë dëshmuar edhe raportet tjera, dallimet gjinore janë drastike: rreth 65% e të anketuarve që janë martuar para moshës 18 vjeç janë femra, kurse 35% meshkuj;

TABELA 1: NUMRI I TË RINJVE TË MARTUAR PARA MOSHËS 18 VJEÇ, SIPAS GJINISË

	14 vjeç	15 vjeç	16 vjeç	17 vjeç	Gjithsej	Përqindja
FEMRA	4	5	10	5	24	64.9%
MESHKUJ	1	4	3	5	13	35.1%
GJITHSEJ	5	9	3	5	37	100%

- Ky dallim gjinor verifikohet përmes pyetjes për moshën e partnerëve të të anketuarve kur janë martuar. Pak më shumë se 31% e të rinjve kanë thënë se partnerët e tyre kanë qenë nën moshën 18 vjeç kur janë martuar. Prej këtyre të anketuarve 35.1% janë femra kurse 64.9% meshkuj. Siç mund të vërehet nga tabela e mëposhtme, numri i meshkujve të cilët janë martuar me vajza nën 18-vjeç është më i lartë në krahasim me numrin e femrave të cilat kanë pohuar se partnerët e tyre kanë qenë nën moshën 18-vjeç kur janë martuar;


TABELA 2: NUMRI I TË RINJVE TË CILËT KANË POUAR SE PARTNERI/JA E TYRE KA QENË NËN 18-VJEÇ/E KUR JANË MARTUAR, SIPAS GJINISË

	13 vjeç	14 vjeç	15 vjeç	16 vjeç	17 vjeç	Gjithsej	Përqindja
FEMRA	0	2	1	2	4	9	26.5%
MESHKUJ	1	1	4	6	13	25	76.5%
GJITHSEJ	1	3	5	8	25	34	100%

- Shumica e të rinjve të intervistuar (91.7%) nuk janë kurorëzuar në komunë kur janë martuar, ndërsa vetëm 40.7% prej tyre kanë raportuar se posedojnë certifikatë të martesës, pra janë kurorëzuar dikur më vonë;
- Përderisa 32% e të rinjve kanë thënë se e kanë braktisur shkollën kur janë martuar, 29.5% kanë raportuar ta kenë vazhduar shkollimin edhe pasi janë martuar. Anketa me prindërit po ashtu tregon se më shumë se gjysma e të rinjve (54%) e kanë braktisur shkollën pas martesës;
- Ndër arsyt kryesore pse të rinjtë nuk e kanë vazhduar shkollimin janë: përkujdesja për fëmijë, familje apo obligimet shtëpiake (16 të anketuar), puna (14 të anketuar), mosha (3 të anketuar), sepse nuk kanë kohë (9 të anketuar), sepse nuk dëshirojnë apo mendojnë se nuk është e nevojshme (9 të anketuar) dhe 1 e anketuar ka thënë se nuk e vijon mësimin për shkak se nuk e lejon burri;
- Shumica e të rinjve kanë thënë se arsyeja kryesore e martesës ka qenë dashuria (74.3%), traditat apo zakonet (17.4%), kushtet ekonomike (1.8%) dhe problemet në familje (6.4%). Përgjigjet janë të ngjashme edhe në mesin e të rinjve të cilët janë martuar para moshës 18 vjeç: 67.7% kanë pohuar se janë martuar nga dashuria, 24.3% për shkak të traditave apo zakoneve, 2.7% për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe 5.4% për shkak të problemeve në familje;


- Përkundër përgjigjeve më lartë, në pyetjen se a kanë pasur presion nga familja për t'u martuar, 18.4% e të rinjve e kanë pohuar këtë gjë dhe kjo shifër është edhe më e lartë për personat të cilët janë martuar kur kanë qenë fëmijë (27%);
- Gjithashtu, përqindja e të rinjve të cilët kanë pohuar se prindërit e tyre kanë qenë të rreptë gjatë fëmijërisë – gjë që mund të ketë ndikuar në vendimin e tyre për t'u martuar - është më e lartë në mesin e të rinjve të cilët janë martuar në moshë jo-madhore (37.4%) në krahasim me mostrën e të gjithë të rinjve të intervistuar (28.4%);
- Edhe pse kushtet e vështira ekonomike nuk janë radhitur si arsye kryesore për t'u martuar nga shumë të rinj, afërsisht 24% e tyre vlerësojnë se gjendja e tyre financiare pas martesës është përmirësuar paksa apo dukshëm. Në anën tjetër, vetëm 13.8% e prindërve vlerësojnë se gjendja e tyre financiare është përmirësuar pas martesës së fëmijëve të tyre;
- Siç mund të shihet në Figurën 1, vetëm gjysma e të rinjve kanë vendosur vet apo së bashku me partnerin/partneren e tyre se duan të martohen (54%). Për 22% të të rinjve të cilët janë martuar nën moshën 18-vjeç të dy prindërit kanë vendosur se ai/a jo duhet të martohet, për 8% ka vendosur e tërë familja, për 5% babai, për 5% gjyshi, e kështu me radhë;

FIGURA 1: VENDIMARRJA PËR MARTESË, SIPAS LLOJIT TË MARTESËS




- Shumica e të rinjve të intervistuar (88.1%) kanë thënë se familja e tyre e ka miratuar martesën e tyre. Megjithatë, kur janë pyetur se çfarë kanë menduar të tjerët për martesën e të rinjve, përqindja e të anketuarve të martuar para moshës 18-vjeç të cilët kanë thënë se të tjerët e kanë kundërshtuar martesën e tyre (27%) është më e lartë në krahasim me mesataren e tërë mostrës/personave të intervistuar (12.8%). Pak më shumë se 28% e prindërve të anketuar po ashtu kanë pohuar se martesat e fëmijëve të tyre janë kundërshtuar nga të tjerët (të afërmit, komshinjtë, et.);
- Më shumë se gjysma e të rinjve të intervistuar (62.4%) mendojnë se martesat e hershme janë ende evidente në komunitetin apo lagjen e tyre. Përqindja e prindërve të anketuar të cilët mendojnë se martesat e hershme janë të përhapura në komunitetin e tyre është pothuajse e njejtë, 63%;
- Sa i përket arsyeve për martesat e hershme, shumica e të anketuarve pohojnë se ato ndodhin për arsye të shumëllojshme. Arsyet më të shpeshta përfshijnë: gjendjen ekonomike (22% e të anketuarve), mentalitetin apo mosdijen (20%), traditat dhe zakonet (15% e të anketuarve), dashurinë (15% e të anketuarve), vetëdëshirën (8% e të anketuarve), rritjen e numrit të anëtarëve të familjes (3%), etj.;

FIGURA 2: ARSYET KRYESORE PËR MARTESA TË HERSHME, SIPAS TË RINJVE TË ANKETUAR



- Sikurse të rinjtë, edhe prindërit e anketuar kanë përmendur faktorë të shumëllojshëm për martesat e hershme. Megjithatë, përgjigjet e tyre dallojnë nga të rinjtë në disa aspekte. Përderisa një përqindje e ngjashme me të rinjtë pohojnë se gjendja e vështirë financiare është njëra ndër arsye kryesore për martesat e hershme (23%), përqindje më e lartë e prindërve në krahasim me të rinjtë besojnë se dashuria (23% e të anketuarve) dhe traditat (21% e të anketuarve) janë arsye kryesore. Përqindja e prindërve që mendojnë se martesat e hershme ndodhin për shkak të mentalitetit (17%) është po ashtu më e lartë në krahasim me të rinjtë e anketuar, ndërsa arsye tjera janë më pak të përmendura;
- Një gjetje shumë interesante që vlen të theksohet është fakti se martesat jashtë shtetit konsiderohen si arsye të martesave të hershme e jo vetëm si martesë.

FIGURA 3: ARSYET PËR MARTESA TË HERSHME, SIPAS PRINDËRVE TË ANKETUAR



ARRITJET

Sa i përket procesit të punës së të rinjve, njëra ndër arritjet kryesore ka qenë dizajnimi i metodologjisë më të përshtatshme e cila do të siguronte grumbullimin e të dhënave të cilat mungojnë nga hulumtimet tjera në terren rreth problematikës së martesave të hershme. Po ashtu, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e temës si dhe aspektin tradicional të kësaj problematike, procesi i dizajnit të pyetësorit i ka shtyrë të rinjtë të mendojnë në mënyrë kreative dhe të diskutojnë se si mund të merren dhe verifikohen në mënyrë të tërthortë informatat të cilat iu nevojiten nga të anketuarit. Duke marrë parasysh joligjshmërinë e martesave të hershme si dhe perceptimet për shkëlqjen e të drejtave tjera të të rinjve (posaçërisht vajzave) pas martesës, procesi i dizajnit të pyetësorit i ka motivuar të rinjtë që të diskutojnë rreth problemeve tjera të ndërthurura me martesat e hershme, duke ngritur kështu vetëdijen e tyre mbi kompleksitetin dhe shumë-dimensionalitetin e problemeve në komunitetet ku jetojnë. Së fundi, duke marrë parasysh që: 1. ky grup ka intervistuar dy gjenerata të ndryshme të të anketuarve, perceptimet e të cilëve mbi martesat e hershme dallojnë shumë nga njëri-tjetri dhe 2. faktin që intervistat në shumë raste janë bërë në prani të anëtarëve tjerë të familjes, gjë që do të ndikonte në përgjigjet e shumë pyetjeve, të rinjtë kanë pasur mundësinë të zhvillojnë dhe avancojnë shkathësitë e tyre për anketime shumë komplekse të cilat trajtojnë tema të ndjeshme.

Sa i përket të arriturave në aspektin e grumbullimit të të dhënave, edhe pse e zhvilluar vetëm në nivel lokal, përmes kësaj ankete janë mbledhur të dhëna mjaft të besueshme mbi praninë dhe përhapjen e martesave të hershme si fenomen në mesin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në komunën e Prizrenit. Duke qenë se të anketuarit e rinj dhe prindërit e tyre janë pyetur për moshën e martesës së tyre/fëmijëve të tyre dhe të partnerëve të tyre (në rastin e të rinjve), përmes anketës është bërë e mundur po ashtu të përcaktohet përqindja e martesave të hershme në krahasim me martesat e personave në moshë madhore si dhe përqindja e martesave të hershme në secilën moshë nën 18-vjeç.

Pastaj, për dallim nga anketat e tjera, kjo anketë dëshmon me tregues të saktë se martesat e hershme kanë ndikim shumë më negativ tek vajzat/femrat. Siç tregon seksioni i gjetjeve kryesore, përqindja e vajzave të cilat janë martuar kur kanë qenë fëmijë është më e lartë në krahasim me meshkujt si dhe numri i atyre që janë martuar kur kanë qenë shumë të rinj/reja, qysh në moshën 14 vjeç, është më e lartë tek vajzat. Gjetjet e anketës po ashtu dëshmojnë se martesat e hershme kur vajzat janë ende fëmijë ndërsa djemtë kanë arritur moshën madhore janë më të shpeshta se anasjelltas, gjë që i bën ato edhe më të rrezikuara në aspektin e planifikimit të familjes dhe fuqisë së vendimmarrjes pas martesës.

Një e arritur shumë e rëndësishme në aspektin e grumbullimit të të dhënave e cila ndërlihet me paligjshmërinë e martesave të hershme dhe me qasjen e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në shërbime publike (posaçërisht arsim dhe shëndetësi), është edhe treguesi se sa përqind e personave të martuar janë kurorëzuar kur janë martuar dhe sa prej tyre posedojnë certifikatë martese tani.

Pastaj, në krahasim me hulumtimet e mëparshme, hulumtimi i **Grupit II** jep informata më specifike dhe të detajuara mbi perceptimet dhe faktorët të cilët mendohet se ndikojnë në martesat e hershme. Posaçërisht kjo e fundit e ka bërë shumë më të lehtë diskutimin dhe hartimin e rekomandimeve për trajtimin e problematikës së martesave të hershme në komunitetet ku jetojnë të rinjtë. Gjithashtu, duke marrë parasysh që anketa ka intervistuar edhe të rinjtë edhe prindërit e tyre, anketa ka bërë të mundur që po ashtu të krahasohen perceptimet mbi martesat e hershme në mes gjeneratave. Pyetjet e tërthorta mbi gjendjen socio-ekonomike të familjeve para dhe pas martesës, rreptësinë e prindërve në shtëpi, miratimin dhe kundërshtimin e martesave nga prindërit, vendimmarrësit e martesës etj., kanë mundësuar verifikimin e arsyeve të radhitura si faktorë që ndikojnë në martesat e hershme.

KUFIZIMET DHE SFIDAT E HULUMTIMIT

Kufizimi i parë i këtij hulumtimi është fakti se të dhënat janë grumbulluar vetëm në disa lagje në komunën e Prizrenit, gjë që e kufizon dobinë dhe përdorshmërinë e tyre në komunat dhe bashkësitë tjera të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë. Së dyti, duke marrë parasysh që të dhënat zyrtare për martesat e hershme pothuajse nuk ekzistojnë fare, verifikimi i të dhënave për përhapjen e këtij fenomeni në bazë të rezultateve të anketës është i pamundur. Së fundi, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e temave të trajtuara, përvojën e kufizuar të të rinjve në hulumtime në terren dhe kohën e shkurtër për të cilën është kryer hulumtimi, ka qenë e pamundur të mbulohen shumë çështje dhe aspekte të ndërlihdura me martesat e hershme – si për shembull dhunën në familje, abuzimin seksual, fuqinë vendimmarrëse të vajzave/grave pas martesës – gjë që e kufizon trajtimin e kësaj problematike në aspekte të shumëfishta në seksionin e rekomandimeve.

REKOMANDIMET

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se faktorët të cilët ndikojnë në martesat e hershme janë të shumëllojshëm dhe shumëfishtë, prandaj edhe trajtimi i këtij problemi duhet të fokusohet në shumë dimensione. Dëshmitë që martesat e hershme janë më të shpeshta për vajzat, gjë që rezultojnë në pasoja të shumta dhe më të rënda për to, po ashtu kërkon trajtim të veçantë për këtë grup të rrezikuar.

Pastaj, duke marrë parasysh paligjshmërinë dhe faktorin tradicional të martesave të hershme, çfarëdo aktiviteti i hartuar për trajtimin e kësaj problematike duhet t'iu kushtojë vëmendje të veçantë këtyre dy aspekteve.

Duke marrë parasysh faktin se martesat e hershme ndodhin për arsye të shumëfishta (kushtet e vështira ekonomike, mungesa e vetëdijesimit, niveli i ulët i arsimimit, traditat dhe zakonet e mëhershme në Kosovë, etj.) dhe shpesh kanë pasoja të cilat përfshijnë dhe përcillen edhe në gjeneratat e ardhshme, aktivitetet/projektet që trajtojnë këtë çështje duhet të jenë gjithëpërfshirëse edhe në aspektin institucional edhe në atë të akterëve. Disa prej sektoreve të cilat do të duhej të angazhoheshin në trajtimin e martesave të hershme përfshijnë: sistemin e mbrojtjes sociale me fokus të veçantë në shërbimet sociale, punën dhe punësimin, sistemin e arsimit dhe sistemin e shëndetësisë. Po ashtu, institucionet dhe zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal janë barabartë të rëndësishëm, prandaj angazhimi i departamenteve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Qendrave për Punë Sociale (QPS), shkollave, zyrtarëve komunal për komunitete, mësimdhënësve, stafit mjekësor nëpër ambulanta dhe Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) është shumë i rëndësishëm.

Së fundi, pjesëmarrja e organizatave joqeveritare (qoftë lokale apo ndërkombëtare), prindërve, të rinjve dhe mediave është esenciale.

Siç perceptohet edhe nga vet të rinjtë dhe prindërit e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, njëra ndër arsyet kryesore përse ndodhin martesat e hershme është mungesa e vetëdijesimit apo mentaliteti në bashkësi. Prandaj, njëri ndër aktivitetet e para që duhet organizuar për trajtimin e kësaj problematike në komunitet do të ishte vetëdijesimi i të rinjve dhe prindërve rreth martesave të hershme. Ky aktivitet do të duhej patjetër të përfshinte elementet në vijim: 1. Martesat e hershme në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, 2. Pasojat e martesave të hershme, me fokus të veçantë në vajzat e reja, 3. Vendimmarrjen në martesë dhe 4. Regjistrimin e martesave në komunë. Ky i fundit është tejet i rëndësishëm edhe për shkak se autoritetet përgjegjëse do të informohen për martesat e hershme, prandaj do të obligohen në njëfarë mënyre të angazhohen në trajtimin e kësaj problematike si dhe do të lehtëson qasjen e të rinjve dhe fëmijëve të komunitetit në shërbime siç janë shëndetësia, arsimi, ndihma dhe shërbimet sociale, programet e punësimit (për të rriturit), etj.

Një aktivitet tjetër drejt vetëdijesimit posaçërisht të të rinjve, edhe pse jo direkt drejtpërdrejtë, është shkollimi i tyre. Aktivitetet të cilat do të organizohen për parandalimin/zvogëlimin e shkollës së braktisjes së shkollës mund të kenë ndikim pozitiv edhe në parandalimin e martesave të hershme.

Prandaj, **Grupi i Punës I** dhe **Grupi i Punës II** duhen bashkëpunuar në hartimin e aktiviteteve për të arritur rezultate në të dyja fushat. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të braktisjes së shkollës në mesin e atyre që martohehen para moshës 18 vjeçare, këto aktivitete si dhe programet të cilat iu ofrohen të rinjve të cilët e kanë të pamundur të vazhdojnë vijimin e mësimin duhen përfshirë patjetër edhe personat të cilët martohehen në moshë të re.

REZULTATET E GRUPIT III

DISKRIMINIMI NGA MËSIMDHËNËSIT**PROBLEMI**

E drejta për arsimim është njëra ndër të drejtat kryesore dhe themelore të njeriut. Arsimiti konsiderohet pikënisje e përfshirjes sociale të grupeve të marginalizuara apo të rrezikuara socio-ekonomikisht, prandaj zhvillimi i kapitalit njerëzor është prioritet i shumë qeverive anembanë botës. Kjo për arsye se përveç që e mundëson përfshirjen sociale të fëmijëve në shoqëri, arsimimi e mundëson dhe lehtëson qasjen e të rinjve dhe të rriturve në tregun e punës dhe iu mundëson atyre të krijojnë të ardhura, duke ndikuar kështu në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe ndërprerjen e përcjelljes së varfërisë në mes të gjeneratave.

Për arsyet e cekura më lartë, varësisht prej kontekstit, shtetet dhe qeveritë përcaktojnë nivelin e arsimimit obligativ në vendin e tyre dhe me këtë zotohen të garantojnë kushtet themelore për përfundimin e tij: barazinë në qasje në arsimim, ofrimin e arsimit obligativ pa pagesë dhe sigurimin e standardeve të larta në arsim. Në Kosovë, arsimiti obligativ sipas legjislacionit definohet si përfundimi i shkollës së mesme të ulët (klasës së 9-të). Megjithatë, sigurimi i përfundimit të shkollës së mesme të ulët për të gjithë fëmijët e moshës shkollore mbetet ende sfidë për të gjitha nivelet e pushtetit të qeverisjes duke marrë parasysh kufizimet fiskale, shkallën e lartë të varfërisë dhe problemet tjera në Kosovë. Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet pakicë, atyre me nevoja të veçanta apo nga grupe tjera të rrezikuara socio-ekonomikisht në sistemin shkollos ngërthen në vete edhe një mori sfidash të tjera, ndër të cilat është edhe diskriminimi.

Sikurse edhe për temat tjera të trajtuara në këtë raport, të dhënat mbi *Diskriminimin nga mësimdhënësit* në shkollat fillore dhe të mesme janë mjaft të mangëta në Kosovë. Për shembull, në raportin e hulumtimit të KFOS-it (2009) në të cilin trajtohen aspekte të ndryshme të gjendjes së komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, për diskriminimin si dukuri flitet vetëm në përgjithësi. Sipas këtij raporti, 50% e personave të cilët kanë pasur kontakt me institucionet qendrore qeveritare janë ndier të diskriminuar. Edhe pse nuk ka të dhëna për to, institucionet të cilat janë më afër komuniteteve në nivel lokal, për shembull institucionet arsimore dhe shëndetësore, konsiderohen më pak diskriminuese (KFOS, 2009, faqe 49). Raporti tjetër i KFOS-it "*Realitet apo fishkekzjarr*" i cili vlerëson implementimin e Strategjisë për Integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas dhe Planin e Veprimit të saj, tregon se MASHT-i ka ndërmarr disa hapa për përmirësimin e qasjes në arsimim për fëmijët e këtyre komuniteteve, duke përfshirë këtu: dhënie e librave shkollore falas, krijimin dhe fuqizimin e ekipeve të cilat përkujdesen për fëmijët të cilët nuk vijojnë apo e kanë braktisur shkollën, ofrimin e shkollimit/orëve jo-zyrtare për fëmijët të cilët e kanë braktisur shkollën, etj. (KFOS, 2013, faqe 42). Megjithatë, çështja e diskriminimit të këtyre fëmijëve mbetet e patrajtuar përkundër perceptimeve dhe dëshmimeve se ky fenomen është evident në sistemin shkollos në Kosovë. Organizatat siç është ECMI tashmë kanë filluar të merren me rastet e veçanta të klasave të ndara/izoluara për fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas nëpër shkolla dhe komuna të ndryshme të Kosovës (ECMI, 2012). Hulumtimi i Grupit të Punës I *Braktisja e shkollës* po ashtu dëshmon se diskriminimi është faktor shumë i rëndësishëm në mosvijimin e mësimin. Mbi 13% e fëmijëve të anketuar në komunën e Prizrenit të cilët e kanë braktisur shkollën kanë thënë që njëra ndër arsyet kryesore ka qenë diskriminimi, përderisa 5% kanë thënë se e kanë ndërprerë mësimin, në mes tjerash, edhe për shkak të mësimdhënësve.

Duke pasur parasysh rëndësinë e qasjes në arsim, mungesën e të dhënave, perceptimet se diskriminimi është shumë i shpeshtë si fenomen në sistemin shkollos (dhe njëra ndër arsyet kryesore të braktisjes së shkollës),

qëllimi kryesor i **Grupit të Punës III** përmes këtij hulumtimi ka qenë të grumbullojë dëshmi mbi ekzistimin e diskriminimit në sistemin shkollor si dukuri dhe mbi format në të cilat shfaqet.

METODOLOGJIA

Për të mbledhur sa më shumë informata rreth ekzistencës së diskriminimit të fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptas nga mësimdhënësit në shkolla fillore dhe të mesme në komunën e Gjakovës ka qenë esenciale që mostra e fëmijëve të intervistuar të jetë sa më e madhe që është e mundur në kohën dhe hapësirën gjeografike të paraparë për hulumtim. Prandaj, të rinjtë kanë intervistuar dy grupe: fëmijët të cilët janë duke vijuar shkollën e mesme të ulët (klasa V-IX) apo të mesme të lartë (X-XIII) dhe prindërit të cilët kanë fëmijë që janë duke e vijuar shkollimin fillor apo të mesëm. Fëmijët të cilët janë duke vijuar shkollën fillore nuk janë intervistuar për këtë temë për shkak se është supozuar se janë shumë të rinj për t'u përgjigjur në pyetjet e anketës. Informatat për diskriminimin e këtyre fëmijëve janë marrë përmes anketës me prindërit.

Pyetësi i anketës ka mundur të mbledhjen e informatave rreth:

- karakteristikave demografike të fëmijëve: gjinia, mosha;
- shkollës që vijnë: klasën, llojin e shkollës;
- diskriminimit të drejtpërdrejtë nga mësimdhënësit: sjellja e mësimdhënësve me fëmijët, kontrollimi i detyrave, vëmendja dhe kujdesi që iu japin gjatë orarit të mësimi;
- diskriminimi i tërthortë nga mësimdhënësit dhe shkolla;
 - pjesëmarrja në orët e mësimi shtesë të ofruara në shkollë, pjesëmarrja në aktivitetet tjera shkollore (kulturore, sportive, etj.), arsytet për mospjesëmarrje në këto aktivitete dhe
 - shoqërimi me fëmijët në klasë, pushim të drekës, shkollë, gjatë dhe jashtë orarit të mësimi.

GJETJET KRYESORE

Anketa *Diskriminimi nga mësimdhënësit* ka mbledhur informata për gjithsej 346 fëmijë të moshës 5-20 vjeç, 149 prej të cilëve janë intervistuar drejtpërdrejtë nga të rinjtë, ndërsa për 237 të tjerët informatat janë mbledhur përmes intervistimit të prindërve të tyre. Përfshirja e prindërve në mostër ka mundur të mbledhjen e informatave për më shumë të rinj në mënyrë që rezultatet e anketës të jenë statistikiisht të rëndësishme dhe të mund të përdoren për të hartuar dhe planifikuar aktivitete në këto komunitete në të ardhmen.

Për të mbledhur informata sa më të larmishme dhe për të siguruar që mostra të jetë e madhe, anketa është zhvilluar në nëntëmbëdhjetë (19) lagje të komunës së Gjakovës: “Bërkoc”, “Dardania”, “Dedë Gjon Luli”, “Edit Durham”, “Ibrahim Fehmiu”, “Haxhi Ymeri”, “Haxhi Zeka”, “Hyrije Hana”, “Lekë Dukagjini”, “Mithat Frashëri”, “Musa Zajmi”, “Piskotë”, “Qabrat”, “Qamëria”, “Qerim”, “Mahalla e Qylit”, “Sadik Pozhegu”, “Sadik Stavileci” dhe “Sefe”.

Disa nga gjetjet kryesore të hulumtimit në terren janë si vijon:


- Të gjithë fëmijët nga lagjet ku janë bërë intervistat vijojnë mësimin në shkolla dhe klasa të rregullta;
- Vetëm 7 nga 149 fëmijët e intervistuar drejtpërdrejtë (4.7%) kanë pohuar se mësimit në shtesë sillen ndryshe me ta në krahasim me nxënësit tjerë, përderisa 12.2% e prindërve kanë raportuar se fëmijët janë ankuar për sjelljen e mësimit në shkollë;
- Nga 7 prindërit të cilët janë përgjigjur për llojin e ankesave të fëmijëve të tyre për mësimit në shtesë, 4 kanë pohuar se fëmijët janë ankuar se mësimit në shtesë janë bërë sikur nuk i dëgjojnë gjatë mësimit, 1 është ankuar se mësimit në shtesë u janë përgjigjur nxënësve tjerë dhe atë e kanë injoruar, 1 është ankuar se mësimit në shtesë nuk ia kontrollojnë detyrat rregullisht, ndërsa 1 është ankuar se mësimit në shtesë ia lënë fajin për të gjitha problemet në klasë;
- Vetëm 5 nga 149 fëmijët e intervistuar (3.4%) kanë thënë se mësimit në shtesë nuk iu përgjigjen kur ata nuk kanë diçka të qartë gjatë orës së mësimit. Nga këta nxënës, njëri ka thënë se në raste të tilla mësimit në shtesë bëhen sikur nuk e dëgjojnë, njëri ka thënë se mësimit në shtesë iu përgjigjen pyetjeve të nxënësve tjerë, kurse i fundit ka thënë se mësimit në shtesë bëhen nervoz në raste të tilla;
- Vetëm 1 nga 149 fëmijët e intervistuar (0.7%) ka thënë se mësimit në shtesë nuk ia kontrollojnë detyrat e shtëpisë;
- Vetëm 6 nga 149 fëmijët e intervistuar (4.03%) kanë thënë se mësimit në shtesë nuk i pyesin para tabelës sikur fëmijët tjerë;
- Rreth 34% të të gjithë fëmijëve (367) nuk marrin pjesë në orët shtesë të gjuhës shqipe, gjuhës angleze, matematikës, etj., të cilat organizohen në shkollë, që lë të kuptohet se diskriminimi i fëmijëve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas është evident në sistemin shkollor edhe pse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mësimit në shtesë;
- Megjithatë, siç mund të vërehet në Figurën 4, vetëm 26% e këtyre fëmijëve mund të mos i ndjekin orët shtesë si rezultat i diskriminimit: 13% kanë thënë se nuk janë informuar për orët e tilla dhe 13% se nuk janë përzgjedhur. Për pjesën tjetër, 19% e të anketuarve kanë thënë se orët e tilla nuk organizohen fare në shkollat që ata vijojnë, 17% nuk janë të interesuar t'i vijojnë ato dhe 17% nuk kanë dhënë ndonjë arsye për mosvijim të orëve shtesë;

FIGURA 4: ARSYET PËR MOSVIJIM TË ORËVE SHITESË (GJUHË SHQIPE, GJUHË ANGLEZE, MATEMATIKË, ETJ) TË ORGANIZUARA NË SHKOLLË



- Përqindja e fëmijëve të cilët nuk marrin pjesë në aktivitete tjera shkollore siç janë kuizet, garat shkollore, aktivitetet sportive, kori i shkollës, koncertet, etj., është edhe më e lartë, 47.1%;
- Siç shihet në Figurën 5, arsyeja kryesore pse fëmijët nuk marrin pjesë në këto aktivitete është se fëmijët nuk janë përzgjedhur nga mësimdhënësit e tyre (32% e të anketuarve), pasuar nga ata që kanë thënë se nuk dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitete të tilla (24%), dhe ata që kanë thënë se nuk janë të interesuar (17%), etj.;

FIGURA 5: ARSYET PËR MOSPJESËMARRJE NË AKTIVITETET E SHKOLLËS (GARA, KUIZE, KORI I SHKOLLËS, AKTIVITETET KULTURORE, AKTIVITETET SPORTIVE, ETJ.)



- Sa i përket ambientit të klasës dhe shkollës, të dhënat e anketës tregojnë se fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas nuk janë të integruar edhe aq mirë. Rreth 75% prej tyre kanë thënë që shumica e fëmijëve tjerë në klasë dhe shkollë nuk janë të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, më shumë se gjysma e fëmijëve (58.2%) kanë thënë se shoku/shoqja e bankës është nga komunitetet RAE përderisa shumica dërrmuese (90%) shoqërohen vetëm me fëmijë të komuniteteve të njehta jashtë orarit të mësimt.

ARRITJET

Sa i përket arritjeve të të rinjve, për shkak të ndjeshmërisë së temës, tërë procesi i dizajnit të metodologjisë së hulumtimit ka qenë sfidues, prandaj mundësitë që të rinjtë të mësojnë dhe zhvillojnë shkathtësitë kanë qenë të shumta. Së pari, grupit punues i është dashur të definojë termin diskriminim si dhe aspektet e ndryshme të cilat mund t'i përfshij diskriminimi në sistemin shkollor. Më pastaj, shumë diskutime janë zhvilluar rreth përcaktimit të mostrës dhe moshës së fëmijëve të cilët do të intervistohen, gjë që ka ngritur vetëdijen e të rinjve për kompleksitetin e hulumtimit mbi temat e ndjeshme, posaçërisht në aspektin e etikës në hulumtim, duke marrë parasysh që rreth gjysma e të anketuarve kanë qenë fëmijë të moshës jo-madhore. Po ashtu, gjatë hartimit të pyetësorit të rinjve iu është dashur të mendojnë për faktorët dhe treguesit e ndryshëm të diskriminimit në sistemin shkollor, edhe ata që janë më së paku të drejtpërdrejtë, gjë që ka nxitur shumë diskutime interesante dhe iu ka mundësuar avancimin e shkathtësive në debat. Së fundi, anëtarët e **Grupit të Punës III** kanë pasur mundësinë t'i zhvillojnë dhe avancojnë shkathtësitë e hulumtimit jashtëzakonisht shumë për arsye se gjatë anketimit është dashur të kenë shumë kujdes se si i parashtronë dhe shpjegojnë pyetjet për të mos ndikuar në përgjigjet e fëmijëve të anketuar.

Sa i përket të arriturave rreth hulumtimit, **Grupi i Punës III** ka mbuluar hapësirë më të madhe gjeografike në krahasim me grupet e tjera, gjë që e përmirëson drastikisht besueshmërinë dhe rëndësinë statistikore të gjetjeve të hulumtimit. Ndërkaq, sa i përket gjetjeve, përmes këtij hulumtimi është vërtetuar se perceptimi për diskriminim nga mësimdhënësit është aq evident në shkollat fillore dhe të mesme në Gjakovë. Një e arritur po aq e rëndësishme është grumbullimi i të dhënave jo vetëm për diskriminimin nga mësimdhënësit por edhe komponentet tjera të ambientit shkollor të fëmijëve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas të cilat ndikojnë mjaft shumë në integrimin e tyre në sistemin arsimor. Këtu përfshihen: ambienti i klasës dhe shkollës, pjesëmarrja në aktivitetet e ndryshme të shkollës, shpeshësia dhe intensiteti i komunikimit të tyre me fëmijët e komuniteteve tjera, e kështu me radhë. Së fundi, edhe pse në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, rezultatet e hulumtimit po ashtu vënë në pah perceptimin e vet fëmijëve dhe prindërve të tyre për prezencën e diskriminimit në sistemin shkollor.

KUFIZIMET DHE SFIDAT E HULUMTIMIT

Një nga sfidat kryesore të raportuara nga **Grupit i Punës III** lidhet me hulumtimin në terren. Përveç kushteve jo të mira atmosferike dhe hapësirës së madhe gjeografike të cilën e kanë mbuluar për një periudhë kohore shumë të shkurtër për t'u siguruar që mostra të jetë sa më e madhe, ky grup e ka pasur shumë të vështirë t'i bind prindërit të japin intervista sepse këta të fundit kanë qenë shumë të paimterësuar dhe nuk e kanë kuptuar se si mund t'ju ndihmojë fëmijëve të tyre ky hulumtim. Grupi po ashtu ka shprehur brengën për besueshmërinë e rezultateve të anketës me prindërit për arsye se, të ndikuar nga zgjedhjet lokale të cilat janë zhvilluar në kohën e anketimit këta të fundit kanë qenë shumë negativ sa i përket angazhimit të institucioneve në përfshirjen/integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në fushat socio-ekonomike dhe sistemin shkollor.

Sa i përket vet hulumtimit, njëri ndër kufizimet kryesore është që ndjeshmëria e temës dhe intervistimi i të anketuarve të moshës jo-madhore ka kërkuar që pyetjet e anketës të jenë të tërthorta, prandaj edhe interpretimi i rezultateve lë të hapur mundësinë e interpretimeve të ndryshme dhe vështirëson krijimin e një pasqyre më të qartë të diskriminimit nëpër shkolla. Një tjetër kufizim shumë i madh është fakti që hulumtimi është i bazuar vetëm në të dhëna sasiore, përderisa tema e diskriminimit si dukuri kërkon analiza më të thukëta të të dhënave cilësore për t'i kuptuar mirë problemet që ngërthen në vete.

REKOMANDIMET

Sipas gjetjeve të këtij hulumtimi, diskriminimi i fëmijëve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në sistemin shkollor në Gjakovë është ende prezent edhe pse jo gjithnjë në përmasa dhe forma siç perceptohet nga pjesëtarët e komuniteteve dhe opinioni i gjerë. Rekomandimet e paraqitura në vijim kërkojnë angazhim të përbashkët nga institucionet qendrore (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Drejtësisë, Gjykatat dhe ministritë tjera), institucionet lokale (Drejtoria Komunale për Arsim, Drejtoria për Komunitete), shkollat (drejtorët, pedagogët, mësime dhënësit, këshillat prindërore) dhe organizatat joqeveritare të cilat veprojnë në këto bashkësi.

Sipas hulumtimit, rreth 5% e fëmijëve të komuniteteve RAE dhe 12.2% e prindërve të cilët kanë fëmijë që vijnë në mësimin në shkollat fillore dhe të mesme në Gjakovë kanë raportuar se diskriminohen nga mësime dhënësit në klasë në forma të ndryshme. Në disa raste mësime dhënësit i kanë diskriminuar të anketuarit dhe fëmijët e tyre duke mos u përgjigjur në pyetjet e tyre, duke i trajtuar ndryshe nga fëmijët tjerë dhe duke mos i pyetur pranë tabelës para tërë klasës.

- Këto të dhëna tregojnë se menaxhmenti i shkollës (duke filluar nga drejtori) duhet përmirësuar monitorimin e zbatimit të rregulloreve për trajtimin e barabartë të secilit nxënës, gjë për të cilën mund të parashtrihen kërkesa dhe të avokohet nga akterë të ndryshëm: këshillat prindërore, ndërmjetësuesit (punonjësit e organizatave joqeveritare lokale) dhe vetë liderët e këtyre organizatave;
- Pastaj, krijimi i një sistemi të ankesave i cili është i lehtë qasshëm në çfarëdo kohe dhe rasti dhe i cili siguron se ankesat nuk do të kenë ndikim negativ në vijimin e shkollës dhe vlerësimin e nxënësve të cilët parashtrojnë ankesa është i domosdoshëm. Ky sistem do të duhej të përfshinte nivele dhe institucione të ndryshme duke filluar nga drejtori i shkollës, drejtorati komunal për arsim, departamenti për komunitete brenda komunës, institucionet gjyqësore në nivel komunal apo rajonal e deri tek MASHT-i në nivel qendror;
- Për të funksionuar një mekanizëm i tillë, komunitetet duhen informuar dhe vetëdijësuar për përdorimin e këtij sistemi dhe për përfitimet që mund t'i kenë nga ai në aspektin e respektimit të të drejtave të tyre. Një aktivitet i tillë informues do të mund të realizohet shumë lehtë përmes angazhimit të organizatave lokale të cilat janë shumë të afërta me komunitetet ku punojnë dhe i njohin mirë pjesëtarët e tyre.

Një tjetër tregues i prezencës së diskriminimit në sistemin shkollor është edhe mospjesëmarrja e fëmijëve në aktivitetet të cilat organizohen jashtë orarit të mësimin siç janë orët shtesë në gjuhën shqipe, angleze, matematikë, etj., si dhe aktivitetet tjera shkollore si garat, kuizet, kori i shkollës, aktivitetet sportive etj. Edhe pse përqindja e fëmijëve të cilët kanë thënë se nuk janë përzgjedhur nuk është shumë e lartë (13% në rastin e orëve shtesë dhe 32% në rastin e aktivitetëve tjera), një numër shumë i lartë i fëmijëve kanë thënë se nuk kanë qenë të interesuar, nuk kanë dëshiruar apo nuk janë informuar për aktivitete të tilla, prandaj nuk kanë marrë pjesë. Këta tre faktorë lënë të kuptohet se fëmijët e komuniteteve përveç që ndoshta nuk inkuadrohen në aktivitete jashtë orarit të mësimin nga mësime dhënësit, sistemi ku ata arsimohen nuk ka krijuar ambient të përshtatshëm i cili nxit fëmijët të

përmirësojnë suksesin e tyre në shkollë apo të zhvillojnë talente tjera në bashkëpunim me fëmijët tjerë. Prandaj, një prej rekomandimeve për trajtimin e kësaj çështjeje do të mund të ishte që shkollat të obligohen (ndoshta edhe prej instancave më të larta institucionale siç është MASHT-i) të përfshijnë sa më shumë fëmijë të komuniteteve RAE në aktivitetet që shkolla organizon jashtë orarit të mësimin. Një gjë e tillë do të mund të përdorej edhe si parakusht për mbështetje (financiare apo tjetër) shtesë për shkollat të cilat kanë rezultate më të mira në nivel lokal.

Duke pasur parasysh gjetjen e këtij hulumtimi se 90% e fëmijëve të komuniteteve RAE shoqërohen vetëm me fëmijë nga komunitetet e tyre pas orarit të mësimin dhe pak më shumë se gjysma e tyre (58%) shokun/shoqen e bankës e kanë të përkatësisë së njejtë etnike, aktivitetet e lartpërmendura do të kishin përfitime të shumëfishta. Së pari, fëmijëve të komuniteteve RAE këto aktivitete do t'ju lehtësonin integrimin në të gjitha suazat e sistemit shkollor. Njëkohësisht, atyre do t'u ofroheshin shumë mundësi për të avancuar/zhvilluar edhe më tutje shkathësitë dhe talentet e tyre. Së fundi, duke qenë se këto aktivitete do të përfshijnë edhe fëmijë tjerë, përmes komunikimit dhe bashkëpunimit të gjithë fëmijët do ta kenë mundësinë të njihen më mirë me njëri-tjetrin, gjë që nuk do të ndikojë vetëm në përmirësimin e ambientit në shkollë por po ashtu do të ketë ndikim pozitiv në aspektin e ngritjes së vetëdijes rreth diskriminimit në planin afat të gjatë, pasi këta fëmijë të jenë rritur.

PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SISTEMIN SHKOLLOR

PROBLEMI

Siç është diskutuar edhe në seksionet e mëparshme në raport, qasja në arsim është një ndër të drejtat më themelore dhe fundamentale të njeriut. Prandaj, sistemi shkollor i cili garanton barazi në qasje në arsimim për të gjithë fëmijët është faktor kyç në përfshirjen sociale të tyre në afat të gjatë kohor. Si rrjedhojë, stigmatizimi, diskriminimi, kultura, problemet me qasje në infrastrukturë, shërbime publike, etj., me të cilat ballafaqohen çdo ditë grupet e marginalizuara siç janë fëmijët me nevoja të veçanta, kërkojnë një sistem tjetër të arsimimit, arsimim gjithëpërfshirës.

Raporti i fundit i UNICEF-it “*E drejta e fëmijëve me nevoja të veçanta për arsimim: Qasje e bazuar në të drejta për arsimim gjithëpërfshirës*” (2012) e definon arsimimin gjithëpërfshirës si sistem në të cilin pranohet nevoja për transformimin e kulturave, politikave dhe praktikave nëpër shkolla për t’i akomoduar nevojat e ndryshme të secilit nxënës dhe në të cilat heqja e barrierave të cilat e pengojnë këtë mundësi është obligative. Me fjalë tjera, sistemi gjithëpërfshirës i arsimimit kërkon që të gjithë fëmijët, përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta, të mos kenë qasje vetëm në sistem të shkollimit por t’ju ofrohen mundësi adekuate të mësimnxënies për të arritur potencialin e tyre të plotë (UNICEF, 2012, faqe 10).

Sikurse edhe shtetet tjera në rajon, Armenia, Azerbejxhani, Bosnja e Hercegovina, Gjeorgjia, edhe Kosova përban komponenten e arsimimit gjithëpërfshirës në planet strategjike kombëtare të arsimimit si dhe në raportet nacionale. Njëri ndër hapat konkret të cilët janë ndërmarr drejtë implementimit të kësaj strategjie është trajnimi i rreth 300 mësimdhënësve të shkollave fillore për metodat inovative të mësimdhënies për fëmijët me nevoja të veçanta. Po ashtu, në Fakultetin e Edukimit të Lartë ka filluar të ofrohet lënda e *Mësimdhënies Gjithëpërfshirëse* në nivelin themelor dhe master (UNICEF, 2012, faqe 80). Gjithashtu, me iniciativën e Save the Children gjatë vitit 2013, Fakulteti Edukimit ka filluar një bashkëpunim me Universitetin e Bologna-s nga Italia, si rrjedhojë e së cilës janë rishikuar kurrikulat ekzistuese për të vlerësuar se sa janë gjithëpërfshirëse si dhe është themeluar një program master për Edukimin Gjithëpërfshirës i cili është akredituar gjatë vitit 2014 dhe do t’i hapë dyert për profesionistët e kësaj fushe gjatë këtij viti.

Save the Children në Kosovë që nga viti 2005 është duke punuar në fushën e Edukimit Gjithëpërfshirës dhe promovimin e modeleve të gjithëpërfshirjes së hershme të fëmijëve me nevoja të veçanta. Përmes programit të tyre për edukimin gjithëpërfshirës, Save the Children aktualisht vazhdon të mbështetë 9 komuna, me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe cilësisë në edukim duke promovuar qasje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse në edukim të fëmijëve nga grupet e marginalizuara. Në bashkëpunim me institucionet qeveritare, Save the Children ka avokuar dhe mbështetur institucionet komunale, përfshirë shkollat parafillore dhe ato fillore, në integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në edukimin publik si dhe ka mbështetur qendrat e rehabilitimit me bazë në komunitet (HandiKOS-in dhe organizatën Down Syndrome Kosova) në mënyrë që ato të ngrisin cilësinë e shërbimeve për këta fëmijë. Për më tepër, 17 institucione parafillore në 7 komuna janë mbështetur me një mori aktivitësh duke përfshirë: burime njerëzore, material didaktik, lojëra dhe grante të vogla shkollore, me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve për këta fëmijë dhe me qëllim që fëmijët me nevoja të veçanta ta përmbushin potencialin e tyre të plotë. Gjithashtu, përmes investimeve në infrastrukturën fizike të shkollave është synuar që t’u mundësohet fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike qasja nëpër objekte shkollore.

Megjithatë, përkundër investimeve dhe mbështetjes së shoqërisë civile në këtë drejtim, implementimi i plotë i konceptit të arsimimit gjithëpërfshirës në aktivitete dhe politika konkrete dhe praktike akoma është mjaft i ngadalshëm në Kosovë, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe aq më tepër për shkak të kufizimeve fiskale. Më shumë se gjysma e fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët vijojnë mësimin ende e vijojnë atë në shtatë (7) shkollat speciale të shpërndara nëpër tërë territorin e Kosovës. Sipas raportit të UNICEF-it “Drejtësia e mohuar: Gjendja e arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovën e pasluftës” (2009), nga 1,081 fëmijët e identifikuar si me nevoja të veçanta të cilët kanë qenë të përfshirë në sistemin e shkollimit në kohën kur është zhvilluar hulumtimi, 511 kanë vijuar mësimin në shkolla speciale kurse 570 në klasë të ndara (speciale) brenda shkollave të rregullta (UNICEF, 2009, faqe 32). Përveç investimeve të mangëta/kufizuara në shkollat ku këta fëmijë vijojnë mësimin, investimet komunale në përmirësimin e infrastrukturës fizike e cila do të përmirësonte qasjen e këtyre fëmijëve edhe në shërbime dhe hapësira tjera publike janë po ashtu shumë të rralla, dhe kjo e fundit paraqet edhe një barrierë shtesë për arsimimin gjithëpërfshirës (UNICEF, 2009, faqe 33).

Problemi kyç me hartimin e çfarëdo politike që iu drejtohet fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë është mungesa e identifikimit të tyre. Ende nuk ekziston ndonjë e dhënë zyrtare e cila konfirmon së paku numrin e përafërt të fëmijëve me nevoja të veçanta. Raporti i lartpërmendur i UNICEF-it (2009) mundohet ta llogaris këtë shifër duke përdorur vlerën mesatare të fëmijëve me nevoja të veçanta në botë, 15-20%. Në bazë të kësaj, numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të moshës shkollore në Kosovë lëkundet në mes të 55,000 dhe 70,000, shifër kjo që dëshmon se më pak se 2% e këtyre fëmijëve në Kosovë janë identifikuar dhe vijojnë mësimin (UNICEF, 2009, faqe 33).

Raporti i lartpërmendur po ashtu diskuton rreth identifikimit të fëmijëve si problem në vetvete sa i përket përfshirjes së tyre në sistemin shkollor. Sipas hulumtimeve, politika de facto e identifikimit të nevojave të veçanta të fëmijëve bëhet përmes prindërve apo shkollave. Në rastin e këtyre të fundit, fëmijët intervistohen nga drejtori dhe/apo pedagogët e shkollës, të cilët pastaj në bashkëbisedim me prindërit vendosin se çfarë lloj shkolle apo klase mund të vijojë fëmija. Megjithatë, të dhënat anekdotike tregojnë se një identifikim i tillë shumë shpesh mund të jetë diskriminues dhe kundërshton parimin e arsimimit gjithëpërfshirës të përkrahur më lartë në këtë kapitull (UNICEF, 2009, faqe 33).

Prandaj, qëllimi kryesor i hulumtimit të **Grupit të Punës IV** është grumbullimi i të dhënave demografike dhe problemeve kryesore me të cilat ballafaqohen fëmijët me nevoja të veçanta në komunën e Gjakovës në aspektin e qasjes në arsimim.

METODOLOGJIA

Ndryshe nga anketat e grupeve tjera të cilat mostrën e kanë përzgjedhur me metodën e rastit, duke trokitur në çdo të tretën derë me radhë në lagjet ku janë zhvilluar anketat apo në lagjet apo oborret e shkollave ku nxënësit vijojnë mësimin, mostra për *Përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor* është përzgjedhur duke marrë listat e përfituesve nga organizatat HANDIKOS³ dhe One-to-One në Gjakovë. Për të pasur informata më të plota për problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët me nevoja të veçanta në aspektin e qasjes në arsimim, **Grupi i Punës IV** i ka intervistuar edhe prindërit e tyre edhe shkollat fillore në Gjakovë.

3 HandiKOS është organizatë e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve në Kosovë. Kjo organizatë ka për mision: parandalimin e aftësisë së kufizuar, promovimin, ofrimin e shërbimeve si dhe njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK).

Baza e të dhënave e anketës së prindërve përmban këto informata:

- Karakteristikat demografike të fëmijëve: moshë, gjinia;
- Llojin e aftësisë së kufizuar të fëmijëve;
- Vijimi i mësimi: klasa, lloji i klasës dhe/apo shkollës (shkollë e rregullt/shkollë speciale);
- Arsytet për mosvijim të mësimi;
- Pjesëmarrja në aktivitetet e organizatave të cilat ofrojnë shërbime për fëmijët me nevojë të veçanta në nivel komunal (HandiKOS, One-to-one, etj.).


Ndërkaq, anketa me shkollat fillore përfshin informatat në vijim:

- Nëse fëmijët me nevojë të veçanta e vijojnë mësimin në shkollë dhe numri i tyre;
- Forma e mësimdhënies në shkollë: klasa të rregullta apo speciale/të ndara;
- Kushtet e ofruara nga shkolla për fëmijët me nevojë të veçanta: qasje horizontale, qasje vertikale, qasje në tualet, qasje në zyrën e drejtorit, arsimtarëve, etj., dhe në qoftë se shkolla ofron asistent personal për këta fëmijë.

GJETJET KRYESORE


Anketa Përfshirja e fëmijëve me nevojë të veçanta në sistemin shkollor ka mbledhur informata për gjithsej 205 fëmijë me nevojë të veçanta të moshës 2-20 vjeç, 61.6% prej të cilëve kanë qenë meshkuj dhe 37.4% femra, dhe gjashtë (6) shkolla fillore ku këta fëmijë e vijojnë kryesisht mësimin. **Grupi i Punës IV** ka mbuluar hapësirën më të madhe gjeografike nga të gjitha grupet, tërë komunën e Gjakovës me disa fshatra përreth, për të intervistuar sa më shumë prindër të fëmijëve me nevojë të veçanta që ka qenë e mundur në periudhën e caktuar kohore prej dy (2) javësh. Anketimi i shkollave fillore ka përfshirë këto shkolla: “Fehmi Agani”, “Mazllum Këpuska”, “Zekeria Rexha”, “Zef Lush Marku”, “Selman Riza” dhe “Mustafa Bakija”.

- Sa i përket llojit të aftësisë së kufizuar të fëmijëve të anketuar, siç mund të vërehet në Figurën 6, rreth gjysma e tyre (47%) kanë aftësi të kufizuar fizike, 24% kanë aftësi të kufizuar mendore, 10% kanë probleme me të dëgjuarit dhe folurit, 9% kanë Sindromin Down, 7% kanë probleme me të pamurit, ndërsa 3% janë të diagnostifikuar me autizëm;

FIGURA 6: LLOJI I AFTËSISË SË KUFIZUAR TË FËMIJËVE

- Edhe pse rreth gjysma e fëmijëve kanë aftësi të kufizuar fizike, vetëm 24 prindër kanë dhënë informata për llojin e mjeteve ortopedike që përdorin fëmijët e tyre: 23 kanë thënë se fëmijët e tyre përdorin karrocë kurse vetëm 1 ka thënë se fëmija përdor paterica;
- Më shumë se 67% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë duke e vijuar mësimin fillor ose të mesëm. Dallimet gjinore në vijim të mësimin janë pothuajse jo-ekzistuese: 31.3% e vajzave me nevoja të veçanta nuk e vijnë mësimin në krahasim me 32.1% të djemve;
- Nga 33% e fëmijëve të cilët nuk janë duke e vijuar mësimin, edhe pse shumë prej tyre japin arsye të shumfishta, mungesa e asistentit personal përmendet si një ndër arsyt kryesore nga 48% e të anketuarve. Më pas, 25% e prindërve kanë thënë se njëra ndër arsyt përse fëmijët e tyre nuk janë duke e vijuar mësimin është sepse nuk janë pranuar nga pedagogu/drejtori i shkollës ku kanë aplikuar; 10% kanë përmendur kushtet ekonomike si një ndër arsyt kryesore, kurse 8% e prindërve kanë përmendur mungesën e infrastrukturës (qasjes fizike) brenda dhe jashtë shkollës dhe mungesën e teksteve shkollore (për fëmijët e verbër) si disa nga arsyt përse fëmijët e tyre nuk e vijnë mësimin;

FIGURA 7: ARSYET PËR MOSVIJIMIN E MËSIMIT



- Sa i përket fëmijëve të cilët janë duke e vijuar mësimin, të dhënat e anketës tregojnë se 38% e tyre e vijojnë mësimin në klasa të rregullta, 43% në klasa të ndara apo speciale për fëmijë me nevoja të veçanta brenda shkollave të rregullta dhe 19% në shkolla speciale.
- Rreth 72% e prindërve të anketuar kanë raportuar se fëmijët e tyre vijojnë aktivitetet e organizuara nga organizatat lokale siç janë HandiKOS, One-to-one, etj. Të dhënat e anketës tregojnë se më shumë se gjysma e fëmijëve (53.5%) të cilët nuk e vijojnë mësimin po ashtu nuk i vijojnë aktivitetet e organizuara nga organizatat e lartpërmendura lokale, ndërsa fëmijët të cilët vijojnë mësimin janë më të rregullt. Rreth 79% e fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët vijojnë mësimin po ashtu vijojnë edhe aktivitetet e organizuara nga HandiKOS, One-to-one, etj.;
- Së fundi, anketa me prindërit tregon se kushtet e papërshtatshme janë arsyeja kryesore përse fëmijët e tyre nuk vijojnë mësimin. Nëntëdhjetë e tre përqind (93%) e prindërve të anketuar kanë thënë se do t'i dërgonin fëmijët e tyre në shkollë po qe se do t'i kishin kushtet ekonomike, po qe se do të ekzistonte infrastruktura e duhur brenda dhe jashtë shkollës, etj.

Sa i përket anketës me shkollat fillore, anketa *Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor* tregon se:

- Fëmijët me nevoja të veçanta e vijojnë mësimin në pesë (5) prej gjashtë (6) shkollave fillore të anketuara;
- Numri i fëmijëve të cilët e vijojnë mësimin në këto shkolla është mjaft i vogël: 3 fëmijë në dy prej tyre, 4 në një të tretën prej tyre, dhe 22 dhe 47 fëmijë në dy të tjerat;
- Në tri (3) prej këtyre shkollave mësimi për fëmijët me nevoja të veçanta ofrohet vetëm në klasa të rregullta, në një të tretën edhe në klasa të rregullta edhe të ndara/speciale, kurse në shkollën e fundit vetëm në klasa të ndara/speciale;

- Nga 5 shkollat ku fëmijët me nevoja të veçanta e ndjekin mësimin, në 3 ka qasje horizontale, do të thotë, qasje në klasat dhe dhomat e katit të parë për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike, ndërsa vetëm në një të prej tyre këta fëmijë kanë qasje vertikale, pra në katet tjera të objektit të shkollës;
- Së fundi, vetëm njëra (1) nga pesë (5) shkollat ku fëmijët me nevoja të veçanta e vijnë mësimin ka asistentë personal për këta fëmijë.

ARRITJET

Arritjet sa i përket zhvillimit të kapaciteteve të të rinjve janë të shumta. Së pari, duke marrë parasysh aftësitë e ndryshme të kufizuara si dhe problemet e ndryshme që secila prej tyre shkakton jo vetëm në qasje në arsimin por edhe në të gjitha aktivitetet tjera ditore të fëmijëve me nevoja të veçanta, kjo iu ka ndihmuar të rinjve të hulumtojnë, diskutojnë dhe mbledhin shumë njohuri rreth kësaj fushe. Së dyti, duke marrë parasysh mungesën e të dhënave dhe vështirësitë në identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta – e shkaktuar pjesërisht edhe nga stigmatizimi i kësaj kategorie të fëmijëve nga shoqëria, gjë që ndikon në hezitimin e prindërve për të dhënë intervista për fëmijët e tyre – të rinjve iu është dashur të mendojnë në mënyrë kreative për përzgjedhjen e mostrës. Së treti, intervistat me familjet e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe bashkëpunimi/komunikimi me dy lloje të institucioneve – organizatat lokale për t'i marrë regjistrat e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe zyrtarët udhëheqës të shkollave – iu ka dhënë mundësi të rinjve të provojnë në praktikë kompleksitetin e problemeve dhe trajtimit të kësaj çështjeje. Pastaj, të rinjtë kanë pasur mundësinë t'i zhvillojnë shkathtësitë e intervistimit tejet mase për arsye se kanë intervistuar një grup mjaft të ndjeshëm i cili zakonisht heziton të flasë për këtë temë (prindërit e fëmijëve) si dhe një grup më zyrtar institucional, që kërkon përshtatje të stilit të anketimit. Së fundi, **Grupi i Punës IV** ka qenë i vetmi nga të katër grupet i cili ka intervistuar një grup më heterogjen të të anketuarve, gjë që do t'i ndihmojë në hulumtimet që do t'i bëjnë në të ardhmen.

Sa i përket hulumtimit, njëra ndër arritjet kryesore është pasqyra më e qartë e vijimit të mësimin nga fëmijët me nevoja të veçanta. Të dhënat mbi përqindjen e fëmijëve të cilët vijnë mësimin, llojin e klasave dhe shkollave në të cilat e vijnë mësimin dhe arsyet për mosvijim të mësimin janë shumë të dobishme për të kuptuar se sa gjithëpërfshirës është sistemi shkollor në Gjakovë, se sa po zbatohet legjislacioni mbi qasjen në arsimin gjithëpërfshirës si dhe fushat ku do të duhej të fokusoheshin aktivitetet e institucioneve qeveritare dhe organizatave lokale e ndërkombëtare në këtë fushë.

Gjithashtu, të dhënat mbi vijueshmërinë e aktiviteteve në organizatat lokale dëshmojnë që ato mund të shërbejnë si ndërmjetësuese në procesin e përfshirjes së fëmijëve në sistemin shkollor, prandaj edhe ato janë shumë të rëndësishme në informimin e hapave të ardhshëm që duhet të ndërmerren nga akterë të ndryshëm. Së fundi, në mes tjerash, me intervistimin e shkollave jepet një pasqyrë më e qartë se çfarë kushtesh ofrojnë ato për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ku duhet fokusuar përpjekjet dhe fondet e institucioneve qendrore dhe atyre lokale sa i përket përmirësimit të sistemit gjithëpërfshirës të shkollimit/arsimit.

KUFIZIMET DHE SFIDAT E HULUMTIMIT

Një ndër kufizimet kryesore të këtij hulumtimi është fakti që të anketuarit përfshijnë vetëm fëmijët të cilët kanë qenë në regjistrat e organizatave HandiKOS dhe One-to-One në Gjakovë, pra fëmijët të cilat tashmë janë identifikuar dhe në njëfarë mënyre janë më të “integruar/përfshirë”, pa marrë parasysh sa të pakta mund të jenë shërbimet që iu ofrohen. Prandaj, të gjitha gjetjet e hulumtimit janë mjaft të mangëta sa i përket rëndësisë

statistikore për arsye se nuk përfshijnë informata mbi fëmijët me nevoja të veçanta të cilët janë të izoluar dhe nuk marrin pjesë as në aktivitetet më themelore ditore.

Së dyti, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e temës, të rinjtë të cilët e kanë kryer hulumtimin në terren kanë raportuar se shumë prindër kanë hezitur të intervistohen dhe japin përgjigje në pyetje të caktuara, gjë që mund të ndikojë në besueshmërinë e rezultateve dhe gjetjeve të anketës.

Pastaj, duke marrë parasysh kohën e kufizuar për kryerjen e anketës dhe problemet e shumëfishta me qasje në arsimim për shkak të pengesave fizike për personat me aftësi të kufizuara fizike, një pjesë e madhe e pyetësorit është fokusuar në këtë lloj të aftësisë së kufizuar. Ky faktor do të kufizojë numrin dhe llojin e aktiviteteve të hartuara kryesisht në këtë grup të fëmijëve. Koha e kufizuar e anketimit për të mbuluar tërë komunën e Gjakovës për të siguruar madhësinë e duhur të mostrës po ashtu ka kufizuar edhe numrin e pyetjeve që kanë mundur t'i bëhen të anketuarve, prandaj, anketa nuk ka mundur të mbledh shumë informata rreth gjendjes socio-ekonomike të familjeve, një faktor shumë i rëndësishëm në përkujdesjen, integrimin dhe mirëqenien e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Së fundi, duke marrë parasysh faktorët social dhe kulturor në perceptimin dhe trajtimin e temës së aftësisë së kufizuar, një kufizim shumë i madh i këtij hulumtimi është pamundësia për të mbledhur të dhëna cilësore.

REKOMANDIMET

Të dhënat e anketës *Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor* tregojnë se 33% e fëmijëve të identifikuar si me nevoja të veçanta nuk e vijnë mësimin. Duke marrë parasysh numrin shumë të ulët të rasteve të identifikuara të këtyre fëmijëve, kjo shifër mund të jetë shumë më e lartë në realitet, prandaj rekomandimi i parë i këtij hulumtimi është grumbullimi i sa më shumë të dhënave rreth fëmijëve me nevoja të veçanta jo vetëm në nivel të bashkësive lokale, por edhe në atë kombëtar.

Sa i përket grumbullimit të të dhënave në nivel lokal, një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta do të mund ta luanin Qendrat për Punë Sociale dhe organizatat lokale të cilat ofrojnë shërbime për këtë grup. Këta të fundit mund të luajnë rol shumë të madh edhe në ndërmjetësimin e integritit të fëmijëve në sistemin shkollor duke qenë se aktivitetet e tyre vijohen edhe nga fëmijët të cilët nuk e vijnë mësimin.

Më pas, duke u bazuar në përgjigjet e prindërve dhe të shkollave për sa i përket qasjes fizike në shkolla si dhe arsyeve për mosvijim të mësimin nga fëmijët, aktivitetet në vijim janë të domosdoshme në të ardhmen e afërt:

- Avokim i fuqishëm dhe i zëshëm i organizatave lokale drejtuar MASHT-it, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe autoriteteve lokale që më shumë fonde të kanalizohen drejtë përmirësimit të infrastrukturës brenda dhe jashtë shkollës (në komunën e Gjakovës) e cila do t'ju mundësonte fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike qasjen fizike për të hyrë në shkollë dhe brenda saj/tyre;
- Avokim i vazhdueshëm nga këto organizata që parimi i arsimimit gjithëpërfshirës i paraparë në strategjinë nacionale për arsimim të zbatohet, pra fëmijët me nevoja të veçanta të mos jenë të ndarë/izoluar nga fëmijët tjerë në shkolla speciale si dhe klasat speciale të shkrihen ngadalë në klasa të rregullta;
- Prindërit dhe organizatat lokale të bashkëpunojnë me shkollat fillore dhe të mesme të cilat kanë numër më të madh të fëmijëve me nevoja të veçanta për të kërkuar nga MASHT-i, MPMS-ja dhe/apo strukturat tjera qendrore dhe lokale që t'i mbështesin në punësimin e asistentëve personal;

- Krijim i strukturave dhe mekanizmave që sigurojnë pranimin e fëmijëve në shkolla nga pedagogët dhe drejtorët. Këto struktura duhet të përfshijnë patjetër bashkëpunim të ngushtë në mes të prindërve, ndërmjetësuesve të organizatave lokale, zyrtarëve të komunës dhe atyre nga MASHT-i, për t'u siguruar që legjislacioni për arsimim gjithëpërfshirës po zbatohet.

KAPITULLI 3

PËRFUNDIMET

ARRITJET, MËSIMET DHE NDIKIMI I HULUMTIMIT NË LIDERËT E RINJ DHE KOMUNITETIN

LIDERËT

Duke pasur parasysh përvojën e kufizuar me hulumtime në terren si dhe moshën e re të liderëve të rinj, i tërë procesi përgatitor për hulumtim, vet hulumtimi dhe diskutimi i rezultateve kanë qenë jashtëzakonisht të dobishme për ngritjen e kapaciteteve të tyre. Përveç mundësisë së zhvillimit dhe avancimit se shkathtësive të hulumtimit pjesëmarrës – duke përfshirë këtu përcaktimin e metodologjisë dhe mostrës, dizajnimin e pyetësorëve dhe anketimin – të rinjtë kanë pasur mundësi të zgjerojnë diapazonin e njohurive mbi problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti i tyre si dhe mbi kompleksitetin dhe shumë-dimensionalitetin e këtyre problemeve. Gjithashu, intensiteti i punës në grup dhe diskutimet brenda në grup dhe ato ndër-grupore gjatë gjithë procesit të punës iu kanë dhënë të rinjve mundësi të shumta për të zhvilluar shkathtësitë e tyre të diskutimit dhe punës ekipore.

Fillimisht, madje para se të fillojë hulumtimi në terren, të rinjve iu është dashur t'i definojnë termet e çështjeve të cilat kanë vendosur t'i hulumtojnë në mënyrë që të përcaktojnë mostrën që duhej anketuar si dhe dizajnuar pyetësorin. Kjo komponentë e procesit ka përfshirë diskutime të shumta rreth të drejtave të njeriut dhe posaçërisht atyre të fëmijëve, rreth faktorëve dhe fushave/ sektorëve të ndryshëm të cilët ndikojnë (janë të ndërlidhur) në problemet e përzgjedhura, si dhe identifikimin e akterëve të shumtë (institucioneve, grupeve dhe individëve) të cilët janë të lidhur me çështjet e caktuara. Me këto aktivitete, të rinjtë janë njoftuar me shumë-dimensionalitetin dhe kompleksitetin e problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet e tyre si dhe për nevojën e një qasjeje gjithëpërfshirëse të trajtimit të problemeve në mënyrë që zgjidhja e tyre të ketë sukses.

Pastaj, gjatë procesit të përcaktimit të metodologjisë dhe mostrës, liderët e rinj janë nxitur të mendojnë në mënyrë kreative se çfarë metodologjie duhet përdorur për të pasur sa më shumë të dhëna reprezentative për popullsinë e cila ballafaqohet me problemin e caktuar si dhe sa më shumë informata nga perspektiva (aspekte) të ndryshme, gjë që do të mundësonte verifikimin e përgjigjeve dhe perceptimeve të të anketuarve. Gjithashu, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e disa prej temave si dhe grupet të cilat janë përzgjedhur për anketim, liderëve iu është dashur të mendojnë për tregues dhe pyetje të cilat masin tërthorazi/në mënyrë jo-direkte perceptimet dhe dëshmitë mbi problemet e përzgjedhura.

Duke marrë parasysh larminë e temave, grupet e ndryshme të cilat i kanë anketuar dhe institucionet e shumta me të cilat kanë kontaktuar, të rinjtë kanë pasur mundësi të shumëfishta për të zhvilluar posaçërisht shkathtësitë e tyre të hulumtimit. Së pari, intervistimi i grupeve të ndryshme – fëmijëve të moshës shkollore, të rinjve, prindërve (posaçërisht kujdestarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara), drejtuesve të shkollave – iu ka mundësuar jo vetëm të zhvillojnë përshtatjen e stilit të intervistimit por edhe njëkohësisht të identifikojnë rolin e secilit prej të lartpërmendurve në çështjet e caktuara. Këtu duhet theksuar patjetër përvojën e intervistimit të të rinjve (të martuar para moshës 18-vjeç), ku mes tjerash janë prekur edhe tema si dhuna në familje, si dhe e prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët kanë hezituar mjaft fuqishëm të intervistohen. Intervistimi i fëmijëve nën

moshën 18-vjeç iu ka dhënë njohuri (sado bazike) rreth etikës së hulumtimit dhe kujdesit të veçantë që duhet pasur gjatë intervistimit të kësaj grupmoshe.

Pastaj, duke marrë parasysh se procesi i hulumtimit ka qenë mjaft sfidues për shkak të përvojës së të rinjve dhe temave komplekse të hulumtimit, liderët janë nxitur nga organizata që të takohen disa herë gjatë procesit për të shkëmbyer përvojat e tyre në terren. Në këtë mënyrë, të rinjtë janë vetëdijesuar për rëndësinë e punës ekipore si dhe efektin e saj në lehtësimin dhe mbarëvajtjen e hulumtimit për rezultate optimale.

Së fundi, vet diskutimi i rezultateve të hulumtimit i ka vetëdijesuar të rinjtë për rëndësinë e hulumtimit në trajtimin e problemeve (në bashkësi si dhe nivele më të larta) si dhe të mendojnë për dallimet në mes të njohurive anekdotike e perceptimeve dhe dëshmive të mbledhura në terren.

ORGANIZATA

I tërë procesit i hulumtimit ka qenë shumë i dobishëm dhe informues për Save the Children.

Organizata do ta përdorë raportin në hartimin e projekteve dhe iniciativave në të ardhmen jo vetëm për shkak të gjetjeve statistikisht të sakta dhe besueshme, por edhe për arsye se temat e hulumtimit janë përzgjedhur nga vetë liderët e rinj të cilët janë aktiv në bashkësitë e tyre si dhe i dijnë më së miri çështjet praktike dhe nevojat e këtyre bashkësive.

Në vitin 2007, Iniciativa 6 ka kryer hulumtimin me titullin: “Vlerësim i gjendjes së komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas” me fokus të veçantë në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Edhe pse ky hulumtim ka qenë mjaft informativ, organizata ka mësuar se për hartimin dhe dizajnimin e aktiviteteve të avokimit, ngritjes së vetëdijes dhe aktiviteteve tjera në bashkësi, për trajtimin e problemeve, hulumtimi i thukët me tema sa më specifike është i domosdoshëm.

KOMUNITETI

Hulumtimi ka pasur mjaft ndikim edhe në komunitetin. Së pari, përmes shpjegimeve dhe elaborimit të pyetjeve dhe fenomeneve nga liderët e rinj, të anketuarve dhe bashkësisë iu është ngritur vetëdija sado pak mbi çështjet për të cilat janë intervistuar.

Pastaj, angazhimi i të rinjve nga vet komunitetet/bashkësitë iu ka dhënë ndjenjën bashkësive se organizata është me të vërtetë e interesuar të kontribuojë në komunitet dhe angazhohet në zgjidhjen e problemeve me të cilat ata ballafaqohen.

Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave për problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas jo vetëm në Kosovë por edhe rajon, vet hulumtimi është shumë i rëndësishëm për t'i kuptuar më mirë problemet dhe çështjet të cilat janë trajtuar. Këtu përfshihen: evidentimi i problemeve/sa janë me të vërtetë prezente këto probleme në bashkësitë ku janë grumbulluar informatat, cilat janë karakteristikat, arsyet, shkaqet dhe disa prej pasojave të tyre, si perceptohen nga bashkësia si dhe si janë të ndërlidhura në mes veti. Siç është mundur të vërehet edhe gjatë analizës së gjetjeve të hulumtimit, të gjitha temat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, prandaj shumë rezultate të grupeve individuale kanë shërbyer si “mjet verifikimi” për rezultatet dhe treguesit e grupit tjetër, gjë që i bën rezultatet e hulumtimit më të besueshme dhe dobishme për hartimin e rekomandimeve për aktivitete në bashkësi nga organizata.

VËSHIRËSITË DHE SFIDAT

Sa i përket metodologjisë së hulumtimit, njëri ndër kufizimet kryesore ka të bëjë me instrumentet të cilat kanë mundur të përdoren për hulumtim. Duke marrë parasysh mungesën e të dhënave rreth komuniteteve dhe temave të trajtuara, si ato rreth komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas ashtu edhe ato me fëmijët me nevoja të veçanta, hulumtimi është dashur të fokusohet në mbledhjen e sa më shumë të dhënave sasiore. Prandaj, duke marrë parasysh kohën e shkurtër si dhe kapacitetet e pamjaftueshme të liderëve të rinj, hulumtimi nuk ka përfshirë instrumente cilësore të cilat janë esenciale, posaçërisht për temat siç janë diskriminimi dhe martesat e hershme. Një tjetër vështirësi apo dobësi në hulumtim është edhe mosekzistimi i hulumtimeve të ngjashme, qoftë edhe në nivel kombëtar, me të cilin do të mund të krahasoheshin dhe verifikoheshin gjetjet e hulumtimit të liderëve të rinj.

Një kufizim tjetër i cili vjen si rrjedhojë e kohës së kufizuar të hulumtimit si dhe përvojës së pamjaftueshme të liderëve të rinj me hulumtime në terren është edhe pamundësia për të mbledhur të dhëna tjera nga të anketuarit, duke përfshirë këtu gjendjen socio-ekonomike/financiare të tyre (për të gjitha temat e hulumtimit); pastaj dhuna në familje, abuzimi seksual, fuqia vendimmarrëse, etj., në mesin e vajzave/të rejave të cilat janë martuar nën-moshën 18-vjeç, etj. Posaçërisht të dhënat mbi gjendjen socio-ekonomike të familjeve janë shumë të rëndësishme për verifikimin e shumë përgjigjeve tjera në të gjitha temat e hulumtimit. Që të gjitha këto e vështirësojnë shpjegimin si dhe pamundësojnë analizën më të thukët të temave të hulumtuara.

Një tjetër vështirësi/problem të cilin e kanë raportuar liderët e rinj është mosinteresimi i prindërve për të dhënë intervista. Kjo ka qenë e ndikuar edhe nga koha e zgjedhjeve lokale të cilat janë mbajtur gjatë kohës së intervistave si dhe nga hulumtimet e shumta në nivel të bashkësisë të cilat rrallëherë janë “transformuar” në përpjekje për përmirësim të gjendjes së familjeve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Prandaj, të pakënaqur edhe me institucionet shtetërore por edhe me akterët tjerë, liderët e rinj kanë shprehur shqetësimin se prindërit kanë mundur të japin përgjigje që nuk përçojnë mendimet/bindjet e tyre të vërteta për shkak të pakënaqësive, gjë që e bën interpretimin e rezultateve sfidues.

Një tjetër vështirësi/shqetësim me besueshmërinë e të dhënave është e ndërlidhur me rrethanat në të cilat janë zhvilluar anketat për temat *Martesat e hershme dhe Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollos*. Në rastin e parë, përgjigjet në anketë, posaçërisht të vajzave/grave të reja të cilat janë martuar para moshës 18-vjeç mund të mos jenë të sakta në rast se janë bërë në prani të burrave dhe/apo familjarëve të burrave të tyre. Ndërkaq, në rastin e dytë, duke marrë parasysh stigmatizimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, përgjigjet nga prindërit mund të mos e reflektojnë saktësisht realitetin.

Një tjetër vështirësi në interpretimin e të dhënave është e ndërlidhur posaçërisht me temat *Martesat e hershme dhe Diskriminimi nga mësimdhënësit*, pyetësorët e të cilave përmbajnë shumë pyetje të tërthorta duke marrë parasysh ndjeshmërinë e temave të cilat i trajtojnë. Prandaj, këto rezultate janë më shumë të bazuara në interpretime dhe supozime, gjë që e kufizon dobënë e tyre në hartimin e rekomandimeve.

Një kufizim shumë me rëndësi që duhet përmendur patjetër është metodologjia e përcaktimit të mostrës për temën *Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollos*. Duke marrë parasysh se kjo mostër është ndërtuar nga regjistrat e organizatave HandiKOS dhe One-to-One, rezultatet e hulumtimit si dhe rekomandimet e nxjerra në këtë raport vlejnë vetëm fëmijët të cilët në njëfarë forme janë të integruar në shoqëri (për arsye se së paku janë identifikuar nga njëra prej këtyre dy organizatave), përderisa gjendja e fëmijëve të këtij grupi të cilët janë ende të izoluar vazhdon të mbetet e patrajtueshme.

REKOMANDIMET

Duke pasur parasysh faktorët e ndryshëm të cilët ndikojnë në secilin prej problemeve të hulumtuar nga liderët e rinj, një rekomandim i përgjithshëm i cili vlen për të dyja komunat si dhe të katër problemet është se çfarëdo projekti/aktiviteti që i drejtohet trajtimit të tyre duhet të fokusohet patjetër në:

- Sektore të shumëfishta: sistemi i mbrojtjes sociale, sistemi i punës dhe punësimit, sistemi i arsimit; sistemi i shëndetësisë; sistemi gjyqësor;
- Nivele të ndryshme të qeverisjes: ministritë në nivel qendror dhe komunat, drejtoritë dhe shkollat në nivel lokal;

dhe të jetë gjithëpërfshirës sa i përket pjesëmarrjes së akterëve, duke përfshirë:

- Zyrtarët në ministritë përkatëse;
- Drejtorët komunal për arsim;
- Drejtorët komunal për shëndetësi dhe mirëqenie;
- Punonjësit e Qendrave për Punë Sociale;
- Zyrtarët komunal për komunitete;
- Drejtorët e shkollave;
- Mësimdhënësit;
- Prindërit;
- Nxënësit/fëmijët/të rinjtë;
- E tërë bashkësia;
- Organizatat joqeveritare lokale;
- Organizatat ndërkombëtare dhe
- Mediat.

Edhe pse për secilën prej temave grupet e punës kanë propozuar rekomandime të veçanta, në seksionin në vazhdim do të paraqiten në formë të listave çështjet që duhen ngritur si probleme në nivelin lokal dhe qendror të qeverisjes, rolin e organizatës dhe të liderëve të rinj në to si dhe aktivitetet më emergjente të avokimit dhe lobimit.

Çështjet që duhen vendosur në rend të ditës të institucioneve qeverisëse urgjentisht janë si vijon:

- Grumbullimi i të dhënave sa më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për problemet e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas si dhe fëmijëve me nevoja të veçanta që janë të ndërlidhura me përfshirjen e tyre sociale në kontekstin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në veçanti. Duhet theksuar se këto të dhëna duhen patjetër të jenë të ndara sipas gjinisë sepse siç tregojnë edhe hulumtimet për këtë raport, dallimet gjinore janë drastike dhe duhen qasur edhe ndaras;
- Implementimi i politikave, strategjive dhe legjislacionit që kanë të bëjnë me arsimimin gjithëpërfshirës, me fokus të veçantë në: 1. Braktisjen e shkollës, 2. Diskriminimin dhe 3. Fëmijët me nevoja të veçanta;
- Implementimi i konventave dhe legjislacionit mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në përputhje me listën e lartpërmendur, aktivitetet më urgjente nga organizata në bashkëpunim me liderët e rinj duhet të përfshijë patjetër:

- Fushata/aktivitete vetëdijesimi mbi të drejtat e fëmijëve dhe martesat e hershme;
- Fushata /aktivitete vetëdijesimi për regjistrimin e martesave – këto janë jashtëzakonisht të rëndësishme edhe për gjeneratat e ardhshme në aspektin e lehtësimit të qasjes në shërbime publike siç janë shëndetësia, arsimi, etj.;
- Fushata /aktivitete vetëdijesimi mbi të drejtat e fëmijëve në arsimim gjithëpërfshirës, me fokus të veçantë në fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptas si dhe fëmijët me nevoja të veçanta dhe grupet tjera të marginalizuara;
- Ndërmjetësim nga organizata dhe liderët e rinj në përfshirjen e fëmijëve të komuniteteve RAE dhe atyre me nevoja të veçanta në sistemin shkollor, duke përfshirë ndërmjetësimin në mes të shkollës-prindërve-nxënësve në rastet e braktisjes së shkollës dhe identifikimin dhe lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve me nevoja të veçanta nëpër shkolla;
- Avokim për më shumë aktivitete gjithëpërfshirëse (ku marrin pjesë fëmijët nga të gjitha komunitetet) jashtë orarit të mësimin dhe jashtë shkollës;
- Avokim i fuqishëm për arsimim gjithëpërfshirës për fëmijët e komuniteteve RAE dhe fëmijët me nevoja të veçanta në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të gjitha institucionet zyrtare.

Sa i përket aktiviteteve tjera në secilin prej problemeve, grupet punuese kanë propozuar edhe aktivitetet e mëposhtme, secila prej të cilave është elaboruar hollësisht në kapitullin përkatës në seksionin e rezultateve të grupeve të punës:

Për trajtimin e Braktisjes së shkollës, në rastet kur vijimi i shkollës është i vështirë/pamundur, duhen patjetër të krijohen mekanizma dhe të ofrohen mundësi që të rinjtë të aftësohen në zanate apo profesione të cilat do ta lehtësonin përfshirjen e tyre në treg të punës dhe do t'u siguronin të ardhura.

Për *Martestat e hershme*, Grupi i Punës II ka propozuar edhe aktivitetet në vijim:

- Vetëdijesimin e të rinjve dhe prindërve rreth martesave të hershme duke përfshirë patjetër këto elemente: 1. Martestat e hershme në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve, 2. Pasojat e martesave të hershme, me fokus të veçantë në vajzat e reja, 3. Vendimmarrjen në martesë dhe 4. Regjistrimin e martesave në komunë;

Për *Diskriminimin nga mësimdhënësit*, Grupi i Punës III ka propozuar edhe këto aktivitete:

- Kërkesë nga organizatat lokale, këshillat e prindërve dhe liderët e rinj që menaxhmenti i shkollave (duke filluar nga drejtori) të përmirësoj monitorimin e zbatimit të rregulloreve për trajtim të barabartë të secilit nxënës;
- Krijimin e një sistemi të ankesave i cili është i qasshëm lehtë në çfarëdo kohe dhe rasti dhe i cili siguron se ankesat nuk do të kenë ndikim negativ në vijimin e shkollës dhe vlerësimin e nxënësve të cilët parashtrojnë ankesa është i domosdoshëm. Ky sistem do të duhej të përfshinte nivele dhe institucione të ndryshme duke filluar nga drejtori i shkollës, drejtorati komunal për arsim, departamenti për komunitete brenda komunës, institucionet gjyqësore në nivel komunal apo rajonal e deri tek MASHT-i në nivel qendror;
- Fushatë vetëdijesimi dhe informimi për përdorimin e këtij sistemi të ankesave nga liderët e rinj dhe organizata (dhe organizatat tjera lokale).

Dhe së fundi, për *Përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor*, Grupi i Punës IV propozon edhe këto aktivitete:

- Avokim të fuqishëm dhe të zëshëm të organizatave lokale drejtuar MASHT-it, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe autoriteteve lokale që më shumë fonde të kanalizohen drejtë përmirësimit të infrastrukturës brenda dhe jashtë shkollës (në komunën e Gjakovës) e cila do t'iu mundëson të fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike qasjen fizike për të hyrë në shkollë dhe brenda saj/tyre;
- Organizim i prindërve dhe organizatave lokale të bashkëpunojnë me shkollat fillore dhe të mesme të cilat kanë numër më të madh të fëmijëve me nevoja të veçanta për të kërkuar nga MASHT-i, MPMS-ja dhe/apo strukturat tjera qendrore dhe lokale që t'i mbështesin në punësimin e asistentëve personal;
- Krijim i strukturave dhe mekanizmave që sigurojnë pranimin e fëmijëve në shkollë nga pedagogët dhe drejtorët. Këto struktura duhet të përfshijnë patjetër bashkëpunim të ngushtë në mes të prindërve, ndërmjetësuesve të organizatave lokale, zyrtarëve të komunës dhe atyre nga MASHT-i, për t'u siguruar që legjislacioni për arsimim gjithëpërfshirës po zbatohet.

REFERENCAT

EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES (ECMI). (KORRIK, 2012). Arsimimi i ndarë/izoluar në Kosovë. Marrë nga:
http://www.ecmikosovo.org/wp-content/Publications/Policy_briefs/2012-07_ECMI_Kosovo_Policy_Brief_Segregated_Education_in_Kosovo/eng.pdf

EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES (ECMI). (TETOR, 2012). Përmirësimi i ofrimit të arsimit për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian: Praktikë më të mira dhe Rekomandime. Doracak për Zyrtarët Komunal. Marrë nga:
http://www.ecmikosovo.org/wp-content/Publications/Hand_book_and_manuals/2012-10_ECMI_Kosovo_Manual_on_Improving_the_Delivery_of_Education_for_Roma_Ashkali_and_Egyptian_Communities_Good_Practices_and_Recommendations/alb.pdf

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI TË HAPUR (KFOS). (2009). Raport i Hulumtimit: Gjendja e Komuniteteve Romë, Ashkali, dhe Egjiptas në Kosovë. Marrë nga:
http://kfos.org/wp-content/uploads/2011/10/Gjendja_e_komuniteteve-Rome_Ashkali_dhe_Egjiptas_ne_Kosove_Raport_i_hulumtimit.pdf

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI TË HAPUR (KFOS). (DHJETOR, 2013). Realitet apo fishekzjarr: Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Marrë nga:
http://kfos.org/wp-content/uploads/2014/01/Reality-or-fireworks_ENG.pdf

LIGJI NR. 2004/32. Ligji për Familjen i Kosovës.

ORGANIZATA PËR SIGURIM DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË (OSBE) – MISIONI NË KOSOVË. (SHTATOR, 2012). Braktisja e shkollës dhe mosvijimi i mësimi në Kosovë. Marrë nga:
<http://www.osce.org/kosovo/95112>

UNESCO. *Guidelines for Inclusion: ensuring access to education for all, 2005, Paris.*

UNICEF. (2009). Drejtësia e mohuar: Gjendja e Arsimimit të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta në Kosovën e Pasluftës. Marrë nga:
http://www.unicef.org/kosovoprogramme/Justice_albanian05.pdf

UNICEF. (2012). The Right of Children with Disabilities to Education: A rights-based Approach to Inclusive Education. Position Paper. Marrë nga:
http://www.unicef.org/ceecis/IEPositionPaper_ENGLISH.pdf

UNITED NATIONS POPULATION FUND (UNFPA) KOSOVO. (OCTOBER, 20120). Child marriage. Marrë nga:
<http://eeca.unfpa.org/webdav/site/eeca/shared/documents/publications/KOSOVO%20-%20English.pdf>

SHTOJCA

GRUPI I PUNËS I: Braktisja e shkollës

LIDERËT:

Nuhi Morina
Valon Gashi
Ylveha Braha
Resul Milaimi
Ilajda Qorri

VULLNETARËT:

Fatlum Kryeziu
Furkan Ago

GRUPI I PUNËS III: Diskriminimi nga mësim- dhënësit

LIDERËT:

Albertina Monika
Wilson Dura
Zejnepe Qabrati
Adelina Kabashi
Besart Mersula

VULLNETARËT:

Alban Morina
Dardan Fetahaj

GRUPI I PUNËS II: Martesat e hershme

LIDERËT:

Sanije Mergjollar
Jemina Osmani
Egzon Sehari
Majlinda Shala
Lavdim Morina

VULLNETARËT:

Amir Osmani
Ergjan Sehari

GRUPI I PUNËS IV: Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor

LIDERËT:

Bleta Qehaja
Masar Derri
Gëzim Qehaja
Avnore Morina
Rreze Oseku

VULLNETARËT:

Granit Hoxha
Bujar Luboja

376-054.57(497)(048)

Hulitim me pjesëmarrje aktive / Raporti është
përgatitur nga Erëblina Elezaj. – [Prishtinë] : Save the
Children, 2014. – 53 f. : ilustr.; 30 cm.

Referencat : f. 55

I.Elezaj, Erëblina

ISBN 978-9951-534-23-9



ISBN 978-9951-534-23-9



9 789951 534239